



*Dialogu mes Qytetarëve dhe Politikanëve Kyç për  
Qeverisje më të Mirë dhe Ekonomi më të Fortë  
Gjetje nga hulumtimi përmes grupeve të fokusuara në Shqipëri*

Të zhvilluara në datat 9 deri 15 Dhjetor 2013



Mars 2014

Ky raport dhe hulumtim i opinionit publik i organizuar nga Instituti Demokratik Amerikan (NDI) në Shqipëri u mundësuan me mbështetjen e Ndihmës Amerikane për Demokraci (NED). Opinione të shprehura në këtë raport janë ato të autorëve dhe nuk reflektojnë këndvështrimet e NED apo të ndonjë individi të organizatave të lartpërmendura.



National Endowment *for* Democracy  
*Supporting freedom around the world*

Copyright © National Democratic Institute 2012. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Pjesët e këtij punimi mund të përdoren ose të përkthehen për qëllime jofitimprurëse, ku NDI të njihet si burim i materialit dhe t'i dërgohen kopje të përkthimit.

## Tabela e Përmbajtjes

Instituti Demokratik Amerikan .....	1
Hyrje 2	
Përmbledhje Ekzekutive .....	4
Gjetjet kryesore .....	10
<b>I PULSI PUBLIK .....</b>	<b>10</b>
<b>II PRIORITETET E QYTETARËVE .....</b>	<b>13</b>
<b>III INTEGRIMI EUROPIAN .....</b>	<b>22</b>
<b>IV PRITSHMËRITE PËR QEVERINË E RE .....</b>	<b>23</b>
<b>V POLITIKA.....</b>	<b>27</b>
<b>VI GRATË NË POLITIKË.....</b>	<b>35</b>
<b>VII AKTIVIZMI QYTETAR .....</b>	<b>40</b>
<b>Aneks A.....</b>	<b>44</b>

## Instituti Demokratik Amerikan

Instituti Demokratik Amerikan është një organizatë jo-fitimprurëse, jo-partiake, jo-qeveritare që i përgjigjet aspiratave të njerëzve në mbarë botën për të jetuar në shoqëri demokratike që njohin dhe promovojnë të drejtat bazë të njeriut. Që nga themelimi i saj në vitin 1983, NDI dhe partnerët e saj kanë mbështetur institucionet dhe praktikat demokratike duke forcuar partitë politike, organizatat qytetare dhe parlamentet, mbrojtur zgjedhjet dhe duke promovuar pjesëmarrjen e qytetarëve, transparencën dhe përgjegjshmërinë e qeverive. Me një staf dhe grup vullnetarësh nga më shumë se 100 vende, NDI sjell bashkë individë dhe grupe për të ndarë praktikat më të mira në zhvillimin demokratik ndërkombëtar, që mund të përshtaten sipas nevojave të vendeve të tyre. Qasja shumëkombëshe e NDI-së përforcon mesazhin se megjithëse nuk ekziston një model i vetëm demokratik, të gjitha demokracitë ndajnë disa parime bazë të përbashkëta, si ato të mishëruara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Në respektim të këtyre parimeve, Instituti promovon kanalet e institucionalizuara të komunikimit midis qytetarëve, institucioneve politike si edhe zyrtarëve të zgjedhur për të përmirësuar jetën e të gjithë qytetarëve.

NDI punon në Shqipëri që nga viti 1991, duke nxitur pjesëmarrjen politike të qytetarëve përmes edukimit civil dhe advokimit, duke rritur pjesëmarrjen publike në vendimmarrje në nivel lokal dhe kombëtar, duke organizuar dhe mbështetur monitorimin e zgjedhjeve dhe edukimin e votuesve, si dhe duke nxitur zhvillimin e partive politike.

Instituti i ka kushtuar vëmendje të veçantë mbështetjes së barazisë gjinore në procesin e tranzicionit demokratik të Shqipërisë. Me financimin e NED (National Endowment for Democracy) dhe Ambasadës së Mbretërisë së Norvegjisë, NDI po mbështet gratë në forcimin e zërit të tyre mbi politikën kyç të reformave gjinore dhe po asiston forumet e grave të partive politike për të advokuar për reformat e brendshme që rrisin rolet drejtuese të grave në politikë.

Si pjesë e strategjisë së përgjithshme në Shqipëri, Instituti synon të promovojë pikëpamjet e qytetarëve si pjesë e ligjërimit politik. Për të dytin vit radhazi, NDI ka kryer një hulumtim me grupe të fokusuar për t'u ofruar drejtuesve politikë e atyre të shoqërisë civile një studim të informuar dhe të paanshëm mbi shqetësimet dhe interesat e qytetarëve, për të mundësuar përkufizimin e mëtejshëm të dialogut mbi prioritetet e tyre përpara fushatave zgjedhore.

Për më shumë informacion lidhur me NDI, ju lutemi të vizitoni faqen e internetit: [www.ndi.org](http://www.ndi.org)

## Hyrje

Zgjedhjet parlamentare të qershorit 2013 sollën ndryshimin e drejtimit politik të vendit pas tetë vitesh. Koalicioni “Aleanca për Shqipërinë Europiane” i drejtuar nga Partia Socialiste (PS), fitoi një shumicë të qartë qeverisëse ndaj Partisë Demokratike (PD) në pushtet. Pas katër vitesh mungese stabiliteti politik që pasoi konfliktin partiak mbi rezultatin e zgjedhjeve të mëparshme parlamentare, Shqipëria ka tanimë mundësinë të realizojë reforma demokratike shumë të nevojshme. Qeveria e re, e drejtuar nga PS dhe Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), pritet që tashmë të përmbushë premtimet e bëra gjatë fushatës në lidhje me transparencën, llogaridhënien dhe performancën e qeverisë. Nën një udhëheqje të re, nga PD pritet luajtja e një roli konstruktiv opozitar në ofrimin e alternativave strategjike ndaj politikave qeveritare.

Në këtë moment kritik në tranzicionin demokratik të Shqipërisë publiku pret që drejtuesit e tyre të zgjedhur ti përfshijnë ata në adresimin e shqetësimeve të vjetra të reflektuara në këtë hulumtim, si papunësia, shëndetësia, arsimi dhe korrupsioni. Për të dhënë një shtysë drejt këtij lloj dialogu dhe ofruar informacion objektiv mbi opinionin e publikut për hartimin dhe miratimin e politikave për këto çështje, NDI ndërmori një studim cilësor të opinionit publik në pesë qytete të vendit gjatë periudhës 9 deri 15 dhjetor, 2013. Ky raund grupesh të fokusuara u mbajt gjashtë muaj pas zgjedhjeve parlamentare dhe tre muaj pas fillimit të punës së qeverisë së re.

Hulumtimi, i cili konsistoi në 10 diskutime grupesh të fokusuara, ka për qëllim:

- Identifikimin e çështjeve prioritare të qytetarëve, për të ndihmuar drejtuesit politikë dhe ata të shoqërisë civile të hartojnë politika që përfaqësojnë sa më mirë këto shqetësime;
- Shqyrtimin e qëndrimeve të qytetarëve në lidhje me performancën e institucioneve shtetërore si dhe me rolin e partive politike e shoqërisë civile; si edhe pritshmëritë për qeverinë e re; dhe
- Shqyrtimin e pikëpamjeve të qytetarëve mbi barazinë gjinore e pjesëmarrjen e grave në politikë si dhe marrjen e rekomandimeve për partitë politike dhe autoritetet qeverisëse.

NDI ka kontraktuar IDRA Research & Consulting, kompani kërkimesh tregu, mediatike dhe sociale për të organizuar studimin në Elbasan, Fier, Korçë, Shkodër dhe Tiranë. NDI ka bazuar përzgjedhjen e qyteteve në numrin e popullsisë, madhësinë si edhe vendndodhjen e tyre gjeografike. Karakteristika të tilla si gjinia, moshë, niveli i të ardhurave, punësimi dhe përkatësia politike u morën parasysh dhe u reflektuan në rekrutimin (e drejtuar) e pjesëmarrësve në grupet e diskutimit, me qëllim mbledhjen e përfytyrimeve nga një shumëllojshmëri qytetarësh.

Grupet e fokusuara përbëheshin nga 8 deri në 10 pjesëmarrës. NDI hartoi një guidë moderimi dhe e finalizoi atë në bashkëpunim të ngushtë me IDRA-n. Për informacion të hollësishëm mbi metodologjinë e studimit, përfshirë procesin e rekrutimit të pjesëmarrësve si edhe hartimin e instrumentit kërkimor, mund ti referoheni Aneksit A.

Diskusimet me moderim në grupet e fokusuara u ofruan qytetarëve mundësinë të reflektojnë mbi drejtuesit politikë e ato të shoqërisë civile të Shqipërisë pas zgjedhjeve, të ofrojnë përfytyrime mbi reformat kyçe, të vlerësojnë iniciativat e reja të qeverisë si dhe të flasin rreth pritshmërive të tyre për të ardhmen. Megjithatë hulumtimi ka për synim konstatimin e pikëpamjeve dhe ndjesive

të qytetarëve në një mënyrë që kapërcen “politikën sipërfaqësore”, ai gjithashtu përfshin, si çështje me interes dhe përqendrim publik, edhe ato çështje që spikasin për kohën kur është kryer hulumtimi. Duke qenë vetëm disa muaj pas formimit të qeverisë së re në mes të shtatorit, në diskutimet e grupeve të fokusuara dolën disa çështje publike të një profili të lartë. Këtu përfshihen: emërimi i kabinetit të ri të ministrave dhe pozicioneve të tjera kyçe, vendimi i qeverisë për të ndaluar importimin e mbetjeve, vendimi për shtyrjen e zbatimit të ligjit për nëpunësit civilë, raportimet mbi largimin e punonjësve publikë për shkak të kalimit të pushtetit, transmetimi televiziv i shembjes së ndërtimeve të paligjshme, si dhe protestat e qytetarëve ndaj propozimit për shkatërrimin e rezervave të armëve kimike siriane në Shqipëri, ndjekur nga vendimi i qeverisë për ta refuzuar propozimin.

**Rezultatet e Grupeve të Fokusuara dhe Përdorimi.** Grupet e fokusuara janë grupe gjysmë-të-strukturuara diskutimi që drejtohen nga një moderator, i cili ndjek një sërë udhëzimesh të para-përcaktuara. Qëllimi i hulumtimit nëpërmjet grupeve të fokusuara është të kuptohen qëndrimet, opinionet dhe eksperiencat e pjesëmarrësve të angazhuar në diskutim. Ndërveprimi ndërmjet pjesëmarrësve në një grup të fokusuar ofron një pasqyrë të mendimit dhe ndjesive të qytetarëve dhe në vetvete ndihmon për të kuptuar arsyet pas qëndrimeve të shprehura dhe nivelin e mbajtjes së këtyre qëndrimeve. Përveç rasteve kur është shënuar ndryshe, përfundimet e prezantuara përgjatë raportit përfaqësojnë pikëpamje të cituara në mënyrë të shpeshtë dhe të përsëritur gjatë diskutimeve në grup. Ekzistojnë edhe pikëpamje alternative, të cilat janë komunikuar në këtë raport vetëm kur janë të rëndësishme ose kur mund të theksojnë një opinion të veçantë.

Hulumtimi nëpërmjet grupeve të fokusuara ka për qëllim evidentimin e llojit dhe drejtimit të opinionit publik dhe jo matjen e saktë apo absolute nga ana sasiore. Pavarësisht se janë bërë përpjekje për t’u siguruar që grupet përfaqësojnë një shtresë të gjerë të shoqërisë dhe se pjesëmarrësit në diskutime përzgjidhen në mënyrë të pavarur, gjetjet e këtij hulumtimi nuk mund të përgjithësohen si statistikisht të vlefshme për të gjithë popullsinë. Informacioni i mbledhur në këtë mënyrë reflekton vlerat dhe nevojat e qytetarëve dhe është shumë i rëndësishëm për të ndihmuar vendimmarrësit të testojnë supozimet e tyre dhe të përfshijnë vullnetin e popullit në politikë-bërje.

Çdo hulumtim i opinionit publik, përfshirë diskutimet me anë të grupeve të fokusuara, përbën një “fotografim” të opinionit në momentin e kryerjes së hulumtimit. Opinioni publik është dinamik dhe evoluon teksa njerëzit përjetojnë dhe reagojnë ndaj ngjarjeve madhore.

Qytetet ku u zhvilluan diskutimet me grupet e fokusuara, pasqyra e të dhënave demografike të pjesëmarrësve si dhe shënimet mbi metodologjinë e studimit, të paraqitura në Hyrje dhe në Aneksin A në fund të këtij raporti, japin informacion më të hollësishëm mbi nëngrupet e pjesëmarrësve të intervistuar për këtë studim.

## Përmbledhje Ekzekutive

Përfundimet e këtij raporti hulumtimi të opinionit publik kanë dalë nga 10 diskutime të mbajtura përmes grupeve të fokusuara në periudhën 9–15 dhjetor 2013, në pesë rajone të Shqipërisë: Tiranë, Elbasan, Shkodër, Fier dhe Korçë.

Ashtu si në hulumtimin me grupe të fokusuara që NDI kreu në tetor të vitit 2012, pulsi publik në Shqipëri mbetet relativisht negativ, dhe mbizotërojnë shqetësimet e vazhdueshme mbi situatën ekonomike, sistemin shëndetësor dhe atë arsimor si edhe mbi korrupsionin. Përmes këtyre shqetësimeve, qytetarët që morën pjesë në këtë hulumtim i dërgojnë vendimmarrësve një mesazh të qartë rreth përparësive të tyre si edhe rreth mënyrës se si do të dëshironin që këto çështje të adresoheshin. Megjithatë, në krahasim me hulumtimin e vitit të kaluar, qytetarët tregohen më të interesuar të luajnë një rol në adresimin e drejtpërdrejtë të këtyre shqetësimeve, për shembull, luftës ndaj korrupsionit – *nëse vërejnë një reagim domethënës nga ana e institucioneve shtetërore*.

Në një masë të gjerë, hulumtimi tregon se qytetarët janë të qartë në dëshirën e tyre për një stil të ndryshëm politike dhe qeverisjeje, i cili nxit pjesëmarrje, përgjegjësi dhe llogaridhënie të të gjithë aktorëve të përfshirë. Pa këtë stil të ri, këndvështrimet negative që pjesëmarrësit kanë mbi politikën, partitë politike dhe parlamentin – të cilat lindin kryesisht nga çfarë ata vetë e përshkruajnë si distancim apo izolim nga politika – do të vazhdojnë të mbeten të tilla. Pjesëmarrësit kërkojnë më shumë kontakte dhe komunikim të vazhdueshëm me të zgjedhurit e tyre dhe liderët e partive për t'u siguruar që këta të fundit të kenë një të kuptuar më të mirë e më drejtpërdrejtë të shqetësimeve dhe nevojave urgjente të qytetarëve. Pjesëmarrësit shprehimisht u kërkojnë politikanëve që:

- Të përmbushin premtimet zgjedhore dhe të mbajnë përgjegjësi kur ato premtime nuk mbahen;
- Të dëgjojnë zërin e qytetarëve, duke komunikuar me ta rregullisht për të kuptuar më mirë shqetësimet e tyre; dhe,
- Të punojnë në mënyrë më efikase për të arritur kompromise përtej përkatësisë politike, për të ofruar politika që përbëjnë zgjidhjet më të mira ndaj shqetësimeve të qytetarëve.

Hulumtimi tregon për një mundësi që u jepet partive politike, përfaqësuesve të zgjedhur dhe autoriteteve qeveritare të përqafojnë mjete më të drejtuara, shumëllojshme dhe të vazhdueshme dialogu dhe angazhimi me qytetarët. Në të njëjtën linjë, hulumtimi sugjeron një dritare për organizatat e shoqërisë civile për t'u pozicionuar si të pavarura nga ndikimet politike dhe si organe të afta për t'i komunikuar zyrtarëve shqetësimet e qytetarëve, sjellë këta të fundit më afër vendimmarrjes, dhe bërë zyrtarët publikë përgjegjës për veprimet e tyre. Në mënyrë të ngjashme, hulumtimi vëren një mundësi që u jepet forumeve të grave brenda partive politike dhe Aleancës së Grave Deputete, të krijuar rishtazi, për t'ia kushtuar profilin dhe pozicionin e tyre brenda partive politike dhe parlamentit përfshirjes së qytetarëve të nënpërfaqësuar, si gratë, në hartimin e politikave.

## I. PULSI PUBLIK

- Me gjithë vlerësimin nga ana e pjesëmarrësve të disa nismave pozitive të ndërmarra nga qeveria, pakënaqësia mbizotëruese me gjendjen e përgjithshme ekonomike përcakton vlerësimin e tyre mbi drejtimin e vendit. **Ekonomia e dobët, të ardhurat e ulëta dhe papunësia përbëjnë shqetësimet kryesore për pjesën më të madhe të pjesëmarrësve.**
- **Një numër pjesëmarrësish shprehën një farë shkalle optimizmi për të ardhmen, kryesisht pasi rezultati i qartë zgjedhor solli një kalim paqësor të pushtetit, pa konflikte politike. Disa kanë shpresë se një kapitull i ri politik mund të favorizojë reformat dhe bashkë me to dhe një performancë më të mirë të qeverisë.** Ky optimizëm i matur përbën një kontrast të shënuar me hulumtimin e vitit të kaluar, ku pjesëmarrësit pothuajse një zëri shprehën mendimin se vendi ishte në drejtimin e gabuar.
- Ashtu si në hulumtimin e vitit të kaluar, pjesëmarrësit e perceptojnë korrupsionin si të përhapur e si shkaktar të funksionit të paefektshëm të institucioneve publike, cilësisë së ulët të shërbimeve publike dhe mundësive të kufizuara që qytetarët kanë, ndër të tjera, për punësim, kujdes shëndetësor dhe arsim.

## II. PRIORITETET E QYTETARËVE

- **Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve e perceptojnë ekonominë si të dobët, çmimet si përgjithësisht të larta, dhe papunësinë si një problem të mprehtë, veçanërisht për të rinjtë.** Pjesa dërmuese e pjesëmarrësve pohojnë se të ardhurat e familjes së tyre janë të pamjaftueshme për të mbuluar nevojat mujore bazë, si faturat e shërbimeve (ujë, elektricitet etj), ushqimet dhe mjekimet.
- **Pjesëmarrësit presin që qeveria të mbajë premtimet për krijimin mundësive të reja për punësim dhe tërheqjen e investimeve,** duke e parë atë si përgjegjëse për zgjidhjen e shqetësimeve kryesore të qytetarëve si papunësia, çmimet e larta dhe pagat e ulëta. Shumë pak pjesëmarrës e shohin sektorin privat dhe komunitetin e biznesit si të aftë dhe/ose përgjegjës për zgjidhjen e këtyre problemeve.
- **Pjesëmarrësit në grupet e fokusuara e shohin korrupsionin si të gjithë-pranishëm në jetën e tyre të përditshme.** Korrupsioni i përhapur shihet nga pjesa më e madhe e pjesëmarrësve si faktori kryesor që kontribuon në standardet e ulëta të shërbimeve publike, qeverisjen e keqe, mos-ndëshkueshmërinë para ligjit dhe arbitraritetin në zbatimin e ligjit. Pjesëmarrësit shohin kujdesin shëndetësor, të ndjekur nga sistemi i drejtësisë dhe ai arsimor, si sektorët më të korruptuar dhe joefikasë. Një numër pjesëmarrësish e shohin korrupsionin si të nevojshëm për të kryer punë dhe pranojnë se vetë qytetarët nxisin praktikatat korruptuese.
- **Pjesëmarrësit duket se përgjithësisht mbështesin fushatën e qeverisë së re kundër korrupsionit, ndonëse disa janë skeptikë për gjasat që ajo të sjellë ndryshime të qëndrueshme nëse nuk zbatohet plotësisht e në mënyrë të drejtë.** Pjesëmarrësit sugjerojnë se rritja e pagave në sektorin publik mund të ulë korrupsionin pasi punonjësit e



sektorit publik, si gjykatësit, doktorët dhe policët, duke pasur punë të mirëpaguara e të qëndrueshme, mund të jenë më pak të prirur të pranojnë ryshfete dhe të marrin përsipër rreziqet që shoqërojnë praktikatat korruptive. Pjesëmarrësit deklarojnë se **zbatimi i rreptë i ligjit dhe ndëshkimi i të korruptuarve do të rriste besimin e tyre në sundimin e ligjit.**

- **Sektori i shëndetësisë shihet nga pjesëmarrësit në grupet e fokusuara si i korruptuar dhe i paefektshëm.** Pjesëmarrësit përmendin se disa prej problemeve më të mprehta që ata hasin kur përballen me sistemin e shëndetësisë janë standardet e ulëta të shërbimit, mungesa e mjekimeve, infrastruktura e papërshtatshme dhe burokracia që pengon procesin e marrjes së librezës shëndetësore. Shumë pjesëmarrës besojnë se **gjendja do të përmirësohej nëse do të kishte më shumë kontroll nga qeveria dhe institucionet e tjera përgjegjëse, më shumë investime në infrastrukturë, si edhe rritje të pagave të personelit mjekësor.**
- Menjëherë pas shëndetësisë, sistemi i drejtësisë citohet si sektori më i korruptuar nga grupet e fokusuara në të gjithë vendin. Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve pohojnë se është e vështirë të marrësh trajtim të drejtë në gjykata nëse nuk u paguan ryshfet avokatëve, prokurorëve apo gjyqtarëve. **Në këndvështrimin e qytetarëve, dështimi i përsëritur i gjyqësorit në dhënien e drejtësisë dhe dënimin e të korruptuarve personifikon mungesën e shtetit të së drejtës në Shqipëri.**
- **Shumica e pjesëmarrësve në diskutime mendojnë se cilësia e arsimit është shumë e dobët.** Ashtu si vitin e kaluar, pjesëmarrësit e shohin korrupsionin në këtë sektor si shumë të përhapur. Ata besojnë se për përmirësimin e këtij sektori ka nevojë për konkurrim të ndershëm për vendet punës për mësuesit, investime në infrastrukturë, vendosje të standardeve më të rrepta për pranimin në universitete dhe më shumë mbikëqyrje nga qeveria. Qytetarët e vlerësojnë vullnetin e qeverisë për të investuar më tepër në arsimin profesional, të cilin pjesa më e madhe e pjesëmarrësve e sheh si një nga zgjidhjet për uljen e korrupsionit dhe të nivelit të papunësisë tek të rinjtë.
- **Ashtu si edhe në hulumtimin e vitit të kaluar, siguria publike përbën një shqetësim për shumë pjesëmarrës nga të gjitha rajonet, me përjashtim të Korçës.** Pjesëmarrësit perceptojnë një rritje të shkallës së krimit, si rrjedhojë të gjendjes së keqe ekonomike dhe nivelit të lartë të papunësisë, veçanërisht tek të rinjtë, por besojnë se reformat e reja në polici kanë gjasa të ndihmojnë.

### III. INTEGRIMI EVROPIAN

- Ashtu si në gjetjet e hulumtimit të vjetshëm, **pjesa më e madhe e pjesëmarrësve në diskutime janë në favor të integrimit në Bashkimin Evropian (BE).** Pjesëmarrësit mendojnë se integrimi evropian do të sjellë më shumë investime në vend, përmirësimin e arsimit, një sistem më të mirë shëndetësor dhe uljen e nivelit të korrupsionit. **Qytetarët e perceptojnë anëtarësimin në BE si një mjet për të monitoruar punën e qeverisë dhe për të fuqizuar sundimin e ligjit në vend. Qytetarët janë të vetëdijshëm se bashkë**

me privilegjet e anëtarësimit në BE, vijnë përgjegjësi dhe detyrime si për qeverinë ashtu edhe për qytetarët.

#### IV. PRITSHMËRITË NGA QEVERIA E RE

Pritshmëritë e pjesëmarrësve për qeverinë dhe vlerësimi i nismave të saj të para janë përgjithësisht pozitive. Ata thonë se ndoshta është shumë herët për të gjykuar në tërësi politikën dhe veprimtarinë e qeverisë, por arrijnë të përmendin disa masa konkrete me të cilat pajtohen në parim, duke përfshirë mbylljen e qendrave të bastit dhe kazinove, prishjen e ndërtimeve pa leje, shfuqizimin e amendamenteve të ligjit mbi menaxhimin e integruar të mbetjeve - të cilat mundësonin importin e mbetjeve, taksimin progresiv, dhe fushatën për luftën kundër korrupsionit. **Shkalla në të cilën qeveria arrin të përmbushë premtimet, të sjellë zgjidhje të prekshme, dhe të menaxhojë pritshmëritë e qytetarëve përmes përpjekjeve të bashkërenduara për të përfshirë qytetarët në këto reforma, do të ndihmojë në rritjen e besimit të qytetarëve në institucionet qeveritare.**

- Pjesëmarrësit shpesh shprehin një shkallë skepticizmi dhe/ose irritimi që disa nga nismat më lart deri tani nuk po adresohen në mënyrë aq efektive ose të plotë sa ç'prisnin. Për shembull, pjesëmarrësit përmendin rastet e qendrave të basteve/kazinove që, menjëherë pas inspektimeve fillestare, ishin rihapur pa një arsye të qartë. Disa të tjerë e perceptojnë prishjen e ndërtimeve pa leje si arbitrare, selektive dhe me një kosto të lartë.
- Të pyetur se çfarë duhet përfshirë në përparësitë kryesore të qeverisë për vitin e parë qeverisës – përveç çështjes së papunësisë, luftës ndaj korrupsionit, përmirësimit të zbatueshmërisë së ligjit dhe sigurimit të rendit publik – pjesëmarrësit gjithashtu theksuan rëndësinë e një sistemi meritokratik rekrutimi në administratën publike dhe mbështetjen e biznesit të vogël. Megjithatë qytetarët mbështesin rekrutimin meritokratik për punësim në administratën publike, ata shprehin skepticizëm për gjatësinë e zhdukjes së favorizimit politik.

#### V. POLITIKA NË PËRGJITHËSI, PARLAMENTI, PARTITË POLITIKE DHE ZGJEDHJET 2013

- Ashtu si në studimin e vitit të kaluar, pjesëmarrësit shprehin mosbesim të politikës në përgjithësi, parlamenti dhe partitë politike, dhe shfaqen skepticizëm për ekzistencën e ndonjë partie politike të interesuar në zgjidhjen e problemeve me rëndësi për qytetarët. Të gjitha partitë politike shihen si njësoj fajtoreshë dhe asnjëra nuk dallohet si e orientuar drejt zgjidhjes së problemeve.

Një pjesë e madhe e pjesëmarrësve kërkojnë që politikanët të mbajnë më shumë përgjegjësi për punën e tyre gjatë periudhave jo-zgjedhore. “Mbani premtimet” është një kërkesë për partitë politike e cila u shpreh shpesh nga pjesëmarrësit e të gjitha grupeve të fokusuara. Shumë pjesëmarrës presin që partitë politike të dëgjojnë dhe të këshillohen me qytetarët në mënyrë që të ofrojnë zgjidhje të shëndosha

politikëbërjeje në fusha të ndryshme si ekonomia, shëndetësia, gjyqësori, rendi publik e të tjera.

- **Një numër pjesëmarrësish i perceptojnë anëtarët e parlamentit si të shkëputur dhe të pandërgjegjshëm për problemet e qytetarëve dhe kushtet në zonat e tyre.** Një numër i konsiderueshëm thonë që nuk e dinë se kush është përfaqësuesi i tyre i zgjedhur. Ata besojnë se deputetët përfaqësojnë interesat e partive të tyre politike dhe kërkojnë që deputetët të tregojnë një njohje dhe të kuptuar më të mirë të problemeve të tyre të përditshme. Pjesëmarrësit shpesh shprehin qëndrime negative dhe cinike ndaj politikës, por gjithsesi kërkojnë të kenë kontakte më të rregullta me deputetët gjatë periudhave midis zgjedhjeve.
- Një numër i konsiderueshëm pjesëmarrësish ankohen për faktin se partitë politike duket se shërbejnë si agjenci punësimi, duke ofruar punë në shkëmbim të votave dhe mbështetjes. Të tjerë rendisin përfitimet e drejtpërdrejta e materiale që vijnë me mundësitë e punësimit si arsye kryesore të angazhimit politik. Pjesëmarrësit sugjerojnë se besohet gjerësisht se partitë politike duhet të ofrojnë punë dhe të mira të tjera materiale për individët, përkundrajt nxitjes së politikave që do të krijonin kushtet ekonomike për rritjen më gjerë të punësimit.
- **Shumica e pjesëmarrësve në grupet e fokusuara presin një opozitë efektive që propozon zgjidhje alternative dhe që mbështet ato politika të propozuara nga qeveria që zgjidhin problemet dhe që janë në interes të qytetarëve.** Pjesëmarrësit nuk mendojnë se opozita duhet të këmbëngulë në armiqësi personale dhe partiake, apo të mbajë qëndrim pengues ndaj çdo veprimi apo propozimi të qeverisë. Ata besojnë se roli kyç i opozitës është të monitorojë qeverinë dhe vendimet e saj, duke kërkuar llogari për përmbushjen e premtimeve zgjedhore dhe denoncuar korrupsionin. Ashtu si për qeverinë, disa pjesëmarrës thanë se është ende shumë herët për të vlerësuar punën e opozitës dhe se është ende i paqartë roli që ajo do të luajë në të ardhmen.
- **Pjesëmarrësit në grupet e fokusuara i konsideruan zgjedhjet parlamentare të qershorit 2013 pozitive,** krahasuar me ciklet e mëparshme zgjedhore. Ky vlerësim bazohet në përshtypjet e pjesëmarrësve se procesi ishte i qetë, i drejtë dhe i menaxhuar më mirë se në të shkuarën. Pavarësisht përmirësimeve të vëna re, disa pjesëmarrës mbeten skeptikë për zgjedhjet, kjo falë akuzave për presion ndaj votuesve dhe për blerje së votave. Ende nuk është rifituar besimi i plotë tek administrimi i zgjedhjeve, kryesisht për shkak të debatit publik rreth përbërjes jo të plotë të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) përpara zgjedhjeve.

## VI. GRATË NË POLITIKË

- **Pavarësisht moshës apo gjinisë, shumica e pjesëmarrësve janë të mendimit se duhet të ketë më shumë gra në politikë** pasi, sipas tyre, ato janë menaxhuese më të mira, më diplomate, më pak të korruptuara dhe të lidhura më ngushtë me shqetësimet e zgjedhësve. Pjesëmarrësit i konsiderojnë femrat si më të orientuara drejt problematikave e politikëbërjes dhe besojnë se femrat janë më në gjendje të nxisin politika që adresojnë shqetësimet e qytetarëve. **Ata theksojnë se përfshirja e perspektivave të grave në**

**zgjdhjen e problemeve kontribuon drejt zgjidhjeve më të qëndrueshme dhe afatgjata.**

- Ashtu si në përfundimet e grupeve të fokusuara të vitit të kaluar, pjesëmarrësit theksojnë se **gratë përballen me vështirësi më të mëdha se meshkujt për t'u angazhuar në politikë dhe se ato janë ende të nën-përfaqësuara, kryesisht për shkak të detyrimeve të shumta familjare dhe shoqërore që iu ngarkohen.** Një numër pjesëmarrësish theksojnë se shumë gra nuk angazhohen politikisht për shkak të normave patriarkale të shoqërisë.
- Të pyetur rreth Aleancës së Grave Deputete, një grup parlamentar i grave i krijuar rishtas në Kuvend, disa pjesëmarrës thanë se kishin dijeni për ekzistencën e tij dhe se besonin se ai mund të jetë një forum i mirë për të nxitur përfshirjen e shqetësimeve të grave në agjendën parlamentare, si dhe për të ofruar zgjidhje për këto shqetësime. Një numër më i vogël pjesëmarrësish theksuan se Aleanca duhet të përqendrohet më shumë në promovimin e çështjeve gjinore në arenën publike dhe sugjeruan se ky grupim duhet nxisë marrjen e masave konkrete në luftën kundër dhunës ndaj grave. Ata besojnë se Aleanca mund të ndihmojë në uljen e tensionit partiak gjatë seancave parlamentare.

## **VII. SHOQËRIA CIVILE DHE AKTIVIZMI QYTETAR**

- Pjesëmarrësit në përgjithësi pranojnë se nuk janë shumë aktivë në komunitetet e tyre. Ata pohojnë se ndjenja e komunitetit në Shqipëri, ose më saktë brenda lagjeve të tyre, është e dobët, dhe se ndërgjegjësimi mbi aktivizmin qytetar është shumë i ulët. Si arsye parësore të mungesës së angazhimit të tyre qytetar në nivel personal, pjesëmarrësit përmendin kufizimet kohore, standardet e ulëta të jetesës, sensin e pakët të vullnetarizmit në të mirë të komunitetit dhe mungesën e leadershipit. Kur u pyetën se çfarë do ta nxiste rritjen e angazhimit qytetar, ata përmendën nevojën për hapësira të përshtatshme për t'u mbledhur si dhe nevojën për udhëheqje dhe vullnet e qartë për të organizuar qytetarët.
- Në përgjithësi, pjesëmarrësit shprehin mosbesim te organizatat jo-qeveritare (OJF-të) dhe/ose pohojnë se shoqëria civile nuk është e mirë-organizuar dhe se rezultatet e saj nuk janë mjaftueshëm të dukshme.
- Ndryshe nga studimi i vjetshëm i grupeve të fokusuara, disa pjesëmarrës pohojnë se **aktivizmi në komunitet është rritur.** Një numër i vogël pjesëmarrësish – të rinj e të moshuar- shprehin se ata vetë janë përfshirë në nisma komunitare dhe të tjerë përmendin projekte ku do të donin të angazhoheshin. Këto kanë të bëjnë kryesisht me infrastrukturën e lagjeve apo çështjet e pastërtisë së mjedisit.

## Gjetjet kryesore

### I PULSI PUBLIK

Diskutimet e mbajtura përmes grupeve të fokusuar në dhjetor 2013 nxjerrin në pah pakënaqësinë që mbizotëron nga situata e përgjithshme ekonomike, e cila përcakton vlerësimin e pjesëmarrësve mbi drejtimin e vendit. Megjithatë, ekziston më thellë një ndjenjë shprese dhe optimizmi të matur se kapitulli i ri politik mund të favorizojë reformat dhe bashkë me to dhe një performancë më të mirë të qeverisë. Kjo pikë shënon kontrast me gjetjet e hulumtimit të vitit të kaluar, ku pjesëmarrësit u përgjigjën thujse njëzëri se vendi po ecte në drejtimin e gabuar.

Grupet e fokusuar tregojnë se pjesëmarrësit, me vendosmëri, e konsiderojnë situatën ekonomike si problemin madhor që ndikon drejtimin negativ të vendit. Pjesëmarrësit menjëherë identifikojnë kushtet e vështira ekonomike — parësisht papunësinë afatgjatë, të ardhurat e ulëta dhe çmimet e larta — si çështjet më shqetësuese që ndikojnë në jetën e tyre të përditshme.

- *“Ne e kemi mësuar në shkollë se jemi vendi më i varfër, në 45-ën, ose vendi më i shkatërruar, sot jemi prapë vendi më i varfër i Evropës. Pra, s’kemi ecur nga ana ekonomike.” (Elbasan, Mashkull)*
- *“Krahasuar me vitet e mëparshme, sivjet është shumë dobët” (Tiranë, Mashkull)*
- *“Mirë do shkojë them unë kur të jenë njerëzit që kanë punë, të kenë të hanë, të pinë, të jetojnë. Këtë dua unë nga qeveria për shembull, nga shteti jonë: punësimin. Do të hajë populli, do të haje kalamani, unë po nuk punova çfarë do ti jap?” (Elbasan, Mashkull)*
- *“Përderisa tek një familje diskutohet ushqimi, për mua është e keqe, është nën nivelin e jetesës përderisa mundesh me i thënë fëmijës ‘mos e ha, se do e hash në darkë’ për mua është e keqe.” (Shkodër, Femër)*
- *“Më përpara ndihmonte emigracioni. Vinim në Greqi... Se unë kam dhe të tërë vëllezërit andej. Vinin ata që andej, më ndihmonin, më jepnin. Për shembull 100 Euro, 200 Euro. Mbetesha keq, më jepte prapë. Tani ai s’ka për vete. (Korçë, Mashkull)*
- *“Përmirësimi s’ka se si me ardh, është e njëjtë me një vit a dy vjet më parë. Ajo (ekonomia) ka pësuar rënie dhe tashi duhet një mrekulli që të përmirësohet.” (Shkodër, Femër)*

Një numër më i vogël pjesëmarrësish në secilin nga grupet e diskutimit janë të rezervuar në dhënien e një gjykimi. Ata shprehen se Shqipëria nuk po ecën as në drejtimin e duhur, as në atë të gabuar, por se ndodhet në udhëkryq. Ata mendojnë se nuk ka pasur kohë të mjaftueshme për të vlerësuar iniciativat e qeverisë së re e për të përcaktuar nëse vendi është tashmë në rrugën e duhur.

- *“Ndoshta është shumë herët për të folur, por përgjithësisht ndihem më mirë dhe goxha optimist. Nuk e di si do ecin gjerat por kam një optimizëm të brendshëm, nuk të them dot që kjo është tamam, kjo nuk është.” (Tiranë, Mashkull)*
- *“As përpara nuk po shkon, po as mbrapa nuk është. Problemi kryesor është respektimi i rregullave dhe i ligjeve. Marrin metoda të gatshme nga vende të përparuara, pa i përshatur me vendin ku ne jemi.” (Tiranë, Femër)*

- “Shpresojmë. Unë nuk e ngrita dorën sepse për mua deri dje, flas para se të ndërrohej sistemi, për mua personalisht nuk ishte ndonjë rrugë e drejtë. Tani unë shpresoj, por është një periudhë shumë e shkurtër që të them që po ecën në rrugën e duhur. Por po shikoj një ndryshim, por është periudhë shumë e shkurtër që të flas me bindje.” (Fier, Femër)
- “Tani, i gabuar drejtimi i vendi nuk më ngjan, por duhen të ndryshohen disa gjëra për më ndryshe.” (Tiranë, Mashkull)
- “Çdo parti që vjen në fillim, gjëja e parë që lufton është korrupsioni. Para katër vjetësh ishte PD [Partia Demokratike] dhe gjëja e parë që sulmoi ishte korrupsioni. Kështu që duhet parë se çfarë do të bëjnë [Partia socialiste në qeveri]” (Elbasan, Femër)
- “Është veç demagogji. Thonë do bëjmë, do bëjmë, do bëjmë dhe ajo që unë shoh është se tek pjesa lekut janë të gjithë keq. Ai ja kaloi Gjermanisë më përpara kurse ky thotë që s’kemi asnjë lek. Janë te dyja ekstreme, dy optika të kundërta. Njerëzit jetojnë me shpresën se do bëhet më mirë. Sepse kemi arritur një stad kur njeriu do që të bëhet më mirë”. (Tiranë, Mashkull)

Krahasuar me pulsën publik të konstatuar në hulumtimin përmes grupeve të fokusuar që NDI mbajti në tetor të vitit 2012, pulsi publik në dhjetor të 2013-ës duket të jetë paksa më optimist. Disa pjesëmarrës, në secilin grup të fokusuar e qark, identifikojnë një numër arsyesh për optimizëm, duke përfshirë kalimin e qetë të pushtetit dhe disa iniciativa të qeverisë.

- “Unë personalisht mendoj, që jemi duke ecur në rrugë të shpresës, sepse ndërtimet pa leje që janë bërë në mënyrë abuzive ata i kanë vënë pak a shumë në rrugën e duhur, ndërsa në lidhje për ekonominë, është tjetër histori.” (Fier, Femër)
- “Në qoftë se flasim për shoqërinë, mendoj, në qoftë se nuk është fasadë, puna e korrupsionit mendoj se ka marrë drejtim.” (Korçë, Mashkull)
- “Konkurrimet që janë bërë për vendet e punës[në administratë], që është një gjë e mirë që kanë bërë.” (Shkodër, Femër)
- “Mendojmë se do ecim drejt, për arsye se më këtë parti të paktën se çfarë po dëgjojmë për rendin, dhe rendi mendoj se është një gjë kryesore” (Korçë, Femër)
- “P.sh, [një gjë që po shkon në drejtimin e duhur është] prishja e ndërtimeve pa leje... Dikujt i pëlqen, dikujt jo. Mbyllja e kazinove asht gjithashtu nai gja e mirë. Edhe policia po sillet ndryshe tani, janë më të rregullt” (Shkodër, Mashkull)
- “[Vendi po shkon] në drejtimin e duhur. Në çdo institucion ke një pritje, një komunikim ndryshe. Ka një frymë tjetër” (Fier, Mashkull)
- “[Gjërat po shkojnë] Në drejtimin e duhur është kjo puna e kempeve që po e luftojnë shumë mirë. Rastet e kempeve që.. ka disa që e marrin kempin kot dhe nuk e merr një njeri që e meriton. Kjo është gjë e mirë dhe që do i hedhin të dhënat në sistem elektronik.”(Elbasan, Femër)
- “Të paktën të sensibilizohen në zbatimin e ligjit, ndryshe pastaj se si zbatohet, por tashmë është duke u ndjerë se je nën zbatimin e ligjeve të shtetit”. (Shkodër, Femër)

Disa pjesëmarrës, nga të gjitha qarqet, citojnë integrimin Euro-Atlantik të Shqipërisë<sup>1</sup> si shenjë pozitive dhe shpresë për një të ardhme më të mirë.

- “[Cilat gjëra po shkojnë në drejtimin e duhur?] Për shembull integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Europian. Udhëtimi pa viza, gjithë ato lehtësira. Shqipëria nuk është më një vend i panjohur.” (Elbasan, Mashkull)
- “Që po ecën mirë është fakti që të dy krahët politikë po mundohen ta fusin Shqipërinë në Evropë. Asnjë gjë tjetër.” (Korçë, Mashkull)
- “Afrimi i Shqipërisë me vendet e Evropës, lëvizja e lirë e njerëzve, presioni që ushtron ose njerëzit duke parë në botë dhe rezultati i kësaj trysnie bën që dhe klasa politike të mos jetë ajo që ka qenë, por ta shohë vetë popullin dhe vetë lidhësin me sy tjetër. Gjë që në njëfarë drejtimi shkon për mirë.” (Elbasan, Mashkull)
- “Jemi OK, duke zgjeruar dhe këtë që u tha, jo thjesht si proces futje në NATO, por kjo do të thotë siguri e një vend, i që këtu ka qenë mentalitet luftë. Të mos harrojmë që deri dje diskutohej akoma me Greket ligji i luftës. Dhe NATO na jep ne siguri. Lëvizja pa viza, integrimin tamam si duhet për në Evropë. Këto janë procese që kanë atë vazhdimësinë e vet. Ndoshta dhe për inerci, pa ndonjë forcë politike, po ka ardhur.” (Elbasan, Mashkull)

Të gjithë pjesëmarrësit ankohen për situatën ekonomike në Shqipëri dhe në zonën e tyre. Pjesëmarrësit jashtë qarkut të Tiranës kanë prirje ta përshkruajnë qarkun e tyre përkatës si më pak të zhvilluar ekonomikisht se kryeqyteti apo vendet fqinje.

- “Elbasani shquhet për një popullsi shumë të madhe, për një varfëri shumë të madhe dhe vazhdon akoma dhe nuk është se ka ndryshuar. Ka më shumë mundësi në Tiranë” (Elbasan, Femër)
- “S’ka vende pune. Det jo, kryeqytet nuk është, kufij nuk ka. Elbasani është qytet i luleve dhe portokalleve. Edhe portokallet po i mbyt greku tani, kështu që...” (Elbasan, Mashkull)
- “Më keq është papunësia. Unë kam një problem timin personal, që unë e kam atë byrektore atje dhe nuk jam në gjendje të paguaj taksat shtetit. Nuk jam në gjendje që unë të kem një siguracion për veten time. Sepse nuk e përballoj dot. Nuk jam në gjendje.” (Fier, Femër)
- “Mjekët tonë ikin në rrethe, ne kemi pasur mjekët më të mirë po asnjëherë s’kanë punuar në Korçë, janë në Tiranë, po them që kanë ikur të gjithë, janë specializuar dhe kanë ikur në Tiranë sepse kanë angazhime dhe motivime të tjera.” (Korçë, Femër)
- “Nëse krahasojmë Shkodrën me Tiranën, kemi mos barazi në rroga, kemi rrogat më të ulëta.” (Shkodër, Femër)
- “Çmimet janë të shtrenjta, flasim për Shkodrën se p.sh në Kosovë ka një supermarket që i gjen gjërat me 0.5 cent ndërkohë që këtu i merr me 1.5 euro.” (Shkodër, Femër)

---

<sup>1</sup> Vendimi i BE-së, në dhjetor 2013, për të mos dhënë statusin e vendit kandidat për Shqipërinë u dha disa ditë pasi NDI përfundoi diskutimet nëpërmjet grupeve të fokusuar. BE ka bërë të ditur planet për rivlerësimin e statusit kandidat në qershor 2014. Shqipëria u bë anëtare e NATO-s në 2009.

## II PRIORITETET E QYTETARËVE

Të pyetur lidhur me shqetësimet e tyre më të mëdha, pjesëmarrësit e pesë qarqeve në mënyrë të përsëritur përmendën ekonominë, korrupsionin dhe kujdesin shëndetësor.

### EKONOMIA

Shumica e pjesëmarrësve e shohin gjendjen e tyre ekonomike si të njëjtë ose si më të keqe se një vit më parë. Pothuajse të gjithë qytetarët bëjnë përgjegjëse qeverinë për performancën e keqe ekonomike. Një numër i vogël qytetarësh shpresojnë se gjendja e tyre ekonomike do të ndryshojë së shpejti.

Ashtu si vitin e shkuar, niveli personal i ankthit të pjesëmarrësve për ekonominë – papunësinë, të ardhurat e ulëta dhe çmimet e larta – lidhet ngushtë me shqetësimet e tyre për situatën e përgjithshme ekonomike. Niveli i ulët i investimeve të huaja dhe vendore për krijimin e vendeve të reja të punës konsiderohet përgjithësisht nga qytetarët si faktor që ushqen papunësinë. Pagat e ulëta u përmendën si të pamjaftueshme për të siguruar elementët bazë të jetesës. Një numër i vogël pjesëmarrësish shprehin pakënaqësi për faktin se sindikatat janë të dobëta dhe e bëjnë qeverinë përgjegjëse për adresimin e nivelit të ulët të ardhurave.

- *“Unë kam dy vajza, i kam të martuara, janë për hesapin e tyre, papunësia si gjithë të tjerët. Nuk kanë ekonomi që të më ndihmojnë dhe mua. Kush është ai fëmijë që ka dhe do ti shikojë prindërit të vuajnë?! I kam studente, për momentin punojnë nga 1-2 ditë në javë që heqin shpenzimet e tyre”. (Fier, Femër)*
- *“Televizori bërtet u çuan rrogat, u çuan rrogat dhe hiç ekonomia nuk ka përmirësim” (Shkodër, Femër)*
- *“Po ka rënë, si nuk ka rënë[ekonomia]. Në qoftë se deri dje bëje 50.000 lekë, sot nuk bën dot as 10.000lekë (Tiranë, Mashkull)*
- *“Krahasuar me vjet, sivjet [ekonomia] është shumë dobët” (Tiranë, Mashkull)*
- *“Unë shoh në Sheraton për shembull, janë bërë gjithë ato shkurtime sepse nuk ka klientë, nuk ka punë. Madje diskutojnë dhe uljen e rrogës. Dhe thonë: Po deshe mirë, në të kundërt jep dorëheqjen dhe ik.” (Tiranë, Mashkull)*
- *“Ka të bëjë me të ardhurat e ulëta. Nuk e përballojmë dot me të ardhura kaq të ulëta. Ndoshta zonjat e tjera nuk e ndejnë ende se kanë fëmijët e vegjël, por meqenëse unë i kam fëmijët më të rritur, nuk e përballoj dot. Me 2 rroga shteti është shumë e vështirë. Çmimet po rriten. Plus, disnivel shumë i madh, dikush ka shumë dikush është tepër i varfër.”(Tiranë, Femër)*
- *“Besoj shteti është përgjegjës [për papunësinë dhe pagat e ulëta] se sindikata s’ka, dhe kur s’ka sindikata, s’ka përgjegjës hiç dhe duhet të mendojë shteti. Nëpër botë, ankohesh te dikush, edhe për të protestuar” (Shkodër, Mashkull)*
- *“Edhe mos-funksionimi i sindikatave është një çështje për tu parë.” (Elbasan, Femër)*
- *“Të hapen vende pune, të rriten rrogat sidomos të atyre që punojnë në fason se punojnë 10 orë dhe marrin 4-5 mijë lekë [të vjetra]dita. Fabrika e këpucëve psh, këpuca shitet*



*100 euro në Itali dhe punëtori nuk merr më shumë se 4-5 mije lekë. Kështu situatash ka shumë”. (Shkodër, Mashkull)*

- *“Duhet të hapen më shumë aktivitete, ku punoj unë kishte gati 100 punëtorë ndërkohë që i previ se nuk ka punë dhe rrogat janë ulur.” (Korçë, Femër)*
- *“Po të mos kemi parasysh kompanitë private që ofrojnë mundësi, shumë njerëz do ishin papunë. Vetëm në një call center që jam unë janë të punësuar gati 200 veta, dmth 200 të rinj, mirëpo për ata 200 te rinj është goxha ndihmë e madhe.” (Elbasan, Femër)*

Siguria e vendit të punës në sektorin publik përbën gjithashtu një shqetësim i cili u ngrit disa herë nga qytetarët gjatë diskutimeve. Një numër i konsiderueshëm i qytetarëve i frikësohen humbjes së vendit të tyre të punës pas kalimit të pushtetit që sollën zgjedhjet e vitit 2013, duke përmendur “politikën e gabuar” si përgjegjëse për këtë fenomen.

- *“Gjithmonë politika e gabuar, sepse ne këtu e kemi këtë gjë, erdhi kjo parti edhe të heqim këta, erdhi kjo parti edhe të heqim këta të tjerët, ndërkohë që e drejta është që kush është i zoti duhet të punojë.” (Korçë, Femër)*
- *“Me gjithë këto njohjet, nëse je me PS do të gjesh punë, nëse je me PD do të zëvendësohesh, tani, po ta zëmë se ishte kryeministri Sali Berisha futi të gjithë krahinën e vet, tani e zëmë kryeministri Edi Rama të marrë të gjithë të njohurit e vet dhe të bëjë të njëjtë procedurë që bëri dhe Saliu.” (Elbasan, Femër)*
- *“Tani [pas zgjedhjeve] do hiqen të gjithë drejtorët, simpatizantët e kësaj partie do kalojnë në krye, ata të tjerët do ikin.” (Korçë, Femër)*
- *“E merr PD ia hedh PS, e merr PS ia hedh PD. Nuk garantojnë njerëzit në punë.” (Fier, Mashkull)*
- *“Njerëzit po pushohen nga puna. Punën e punës e kemi me frikë.” (Korçë, Femër)*

## **KORRUPSIONI**

Ashtu si edhe në hulumtimin me grupe të fokusuar që NDI bëri në tetor 2012, shumica e qytetarëve që morën pjesë në diskutime e konsiderojnë korrupsionin si gjerësisht të përhapur në vend, dhe si dukuri e cili midis të tjerash i privon ata nga mundësitë për punë, kujdes shëndetësor dhe arsim. Sektorët që konsiderohen më të korruptuarit janë shëndetësia, e ndjekur nga gjyqësori dhe arsimi.

Pjesëmarrësit mendojnë se ryshfeti nevojitet për pothuajse gjithçka, duke filluar nga aksesit në sistemin shëndetësor deri në gjetjen e një pune, marrjen e një diplome, apo ndërveprimin me sistemin e drejtësisë. Sikurse edhe në vitin e shkuar, pjesëmarrësit e shohin korrupsionin si predominant dhe të dëmshëm, por në të njëjtën kohë si i domosdoshëm për të mbaruar punë.

- *“[Korrupsioni] është kudo – Në shkollë, polici, mjekësi.” (Shkodër, Mashkull)*
- *“Pikat më kyçe janë të korruptuara, arsimit, shëndetësia, gjykata. Kjo e ka bërë edhe krejt rininë pesimiste që don me ik jashtë shtetit pasi mendojnë se këtu nuk jetohet, nuk punohet, janë bërë të gjithë të korruptuar dhe krejt rinia është bërë pesimiste, nuk ju bëhet me punë. Ca kam parë, kanë dashur me ik jashtë shtetit se në këtë vend nuk jetohet.” (Shkodër, Femër)*

- *“Tani që unë shkoj kërkoj punë në zyrën arsimore dhe unë që kam mbaruar shkollën, master, kam mesatare të lartë, kam mbaruar në Tiranë, pretendoj që të gjej një vend pune atje dhe nuk e gjej sepse hyn dikush tjetër, në një anë tjetër, i gjen mikun, i gjen formën për të zënë vendin e punës dhe unë ngelem prapë këtu ku jam.” (Elbasan, Femër)*
- *“Dua të them këtë, dhe ata me nota të mira dhe ata me nota të këqija me lekë futen, me korrupsion. Nuk janë vetëm ato me nota të këqija. Nuk futen dot pa ndihmën e mikut apo të lekut.” (Elbasan, Femër)*
- *[Korrupsioni është i nevojshëm]”Me ble, me ble vendin e punës, me ble ilaçet në spital është korrupsion, një diçka që s’na takon me e kry dhe ne e kryejmë.” (Shkodër, Femër)*
- *Grup diskutimi me gratë, në Korçë:*
  - *Pjesëmarrësja e parë: “Unë kam mbaruar para 2 vjetësh për mësuesi dhe kam dhënë edhe provimin e shtetit, të gjitha dhe kudo më thonin që ke prioritet dhe emri im ngeli prioritet.”(Korçë, Femër)*
  - *Pjesëmarrësja e dytë: “Kjo është normale se që të zësh punë duhet të bësh 3000 euro në zarf e t’ja japësh. Se sa merr ai që të bën punën, kjo është pjesa tjetër.” (Korçë, Femër)*
- *“Po jemi ne në një farë mënyre që kemi nxitur korrupsionin, sepse në qoftë se ti nuk i jep diçka ai do e bëjë punën gjithësesi. Rasti tjetër është që paguhet [për punë], u fute qëndrove një muaj, dy muaj, tre muaj - po dole se tjetri pagoi më shumë se ty edhe të zuri vendin e punës.” (Elbasan, Femër)*
- *“Jena popull që e pranojmë korrupsionin, jena mësu kështu, se gjëja e parë që bëjmë kur shkojmë te një spital ne i japim vetë lekët.” ( Shkodër, Femër)*
- *“Korrupsioni mendoj se i ka kaluar masat, pasi jo vetëm në popull por edhe korrupsioni në tendera, pasi ne kemi shumë pasuri tokësore, kemi minerale, kemi naftë.” ( Shkodër, Femër)*

Në mbarë vendin, pas sektorit të shëndetësisë, gjyqësori shihet si sektori më i korruptuar. Shumica e pjesëmarrësve thonë se është vështirë të marrësh trajtim të drejtë në gjykatë nëse nuk u paguan rryshfet avokatëve, prokurorëve apo gjykatësve.

- *“Po të krahasosh korrupsionin në polici me atë në drejtësi, korrupsioni në polici është pothuajse zero”(Korçë, Mashkull)*
- *“E para drejtësia (sektorët më të korruptuar). Sepse ti paguan dhe del nga burg.”(Tiranë, Mashkull)*
- *“Ka tregu koha se vetëm me lekë shpëton nga gjyqësori.” (Shkodër, Mashkull)*
- *“Korrupsioni në drejtësi ka të bëjë me këtë që x-person ka vrare kaq veta [pa ndonjë arsye] dhe ti vret me çifte se erdhi dhe të vodhi 4 lopët ai dhe ti hyn ne burg për 20 vjet, kurse ai që ka vrare 4 me ndihmën e politikanëve të majtë a të djathtë i bën nja 4-5 vjet edhe del nga burg.” (Korçë, Mashkull)*
- *“Është një sistem i korruptuar gjyqësor, kur një gjykatës në dorë merr 5 milion lek për të marrë një çështje dënimi ose një vrasje. Çështje shumë serioze. sistemi gjyqësor është totalisht i kalbur. Duhet një rikonstruksion në sistemin gjyqësor, duhet bërë në Shqipëri.” (Fier, Mashkull)*
- *“Edhe ata (gjyqësori) janë të korruptuar. Për shembull. Është tjetri në burg. Kap avokatin dhe i thua do të jap kaq, më nxirr filanin. Ai nxjerr kriminelin jashtë. Do paguajë ai, do paguajë miliona.” (Elbasan, Femër)*

Pjesëmarrësit përgjithësisht e mbështesin fushatën e qeverisë kundër korrupsionit. Por, duke e parë korrupsionin si të rënjosur thellë në shoqëri, ata janë skeptikë për shanset e kësaj fushate për të qenë e suksesshme dhe vënë në pikëpyetje zbatimin e plotë të saj.

- *“Tani mesa shoh unë, me ndryshimin e qeverisë shoh një luftë të madhe ndaj korrupsionit, çfarë është ajo që po na pengon herë pas here.” (Elbasan, Femër)*
- *“Nuk mendoj se është fasadë, puna e korrupsionit mendoj se ka marrë drejtim.” (Korçë, Mashkull)*
- *“Qeveria po mundohet, po korrupsioni nuk mund të zhduket kaq kollaj. Po mesa po dëgjojmë, ca gjëra kanë ndryshuar.” (Korçë, Mashkull)*
- *“Me sa shoh, me sa ndjekim në televizion që ka arrestime të shumta të këtyre që bëjnë korrupsion. Në bazë të atyre që i kanë nxjerrë në emisionet televizive apo dhe vetë qytetarët.” (Elbasan, Femër)*

Shumë pjesëmarrës besojnë se rritja e pagave do të zvogëlonte korrupsionin pasi për aq kohë sa gjyqtarët, doktorët dhe policët kanë një qëndrueshmëri ekonomike dhe një punë të sigurt, ata nuk do të rrezikonin humbjen e punës, reputacionit apo licencës së tyre duke marrë rryshfet. Qytetarët, fuqishëm, sugjerojnë zbatimin e ligjit dhe ndëshkimin e të korruptuarve për luftën ndaj korrupsionit.

- *“[Si mund ta luftojmë korrupsionin?] Duke zbatuar ligjin, dhe duke qenë të gjithë të barabartë përpara ligjit.” (Tiranë, Mashkull)*
- *Grup diskutimi nga meshkuj në Shkodër:*
  - Pjesëmarrësi i parë: *“Unë nuk e di nëse ka ndonjë prej nesh që e denoncojnë korrupsionin.”*
  - Pjesëmarrësi i dytë: *“Se nuk na intereson ta luftojmë.”*
  - Pjesëmarrësi i parë: *“Po sepse nuk ke besim që do ta ndjekin denoncimin.”*
- *Grup diskutimi nga meshkuj në Shkodër:*
  - Pjesëmarrësi i parë: *“Masa e parë është me i çue rrogat, se një polic që merr 350 mijë lek dhe që është vetë i 5-6-sht në shpi nuk i del aq, dhe normal që është i detyrum të bëjë korrupsion.”*
  - Pjesëmarrësi i dytë: *“Edhe një gjë tjetër, asht e rëndësishme që të rritet kontrolli dhe të dënohen ata që shkelin ligjin. Kjo asht e rëndësishme, që polici as vetë nuk është i sigurt për vete, ai asht një qytetar i thjeshtë, nuk është duke thyer rregullat.”*
  - Pjesëmarrësi i parë: *“Dhe ligji duhet të jetë i njëjtë për të gjithë.”*
- *“[Si luftohet korrupsioni?] Të zbatohet ligji, të ndëshkohet kushdo që të kapet në rast korrupsioni, kushdo, në shëndetësi, arsim dhe drejtësi.” (Tiranë, Mashkull)*
- *“Njerëzve iu mungon besimi në institucione, qoftë edhe media, e cila mund të jetë institucion [për të ndihmuar në luftën ndaj korrupsionit]. Duhet të kthejmë besimin e njerëzve, të luftojmë korrupsionin, edhe përmes internetit ku njerëzit mund të hedhin dy a tre foto dhe të denoncojnë rastet.” (Korçë, Femër)*
- *“Duhet të marrin në punë vetëm njerëz që janë të aftë të bëjnë punët, si për doktorët, infermierët, apo prokurorët.” (Fier, Femër)*
- *“Unë shikoj një problem tjetër me individët, që është mungesa besimit në ligje dhe rregullat. Kudo ka tabela me ligje dhe rregulla. Të gjithë i shkelin, por nëse bëhemi*

*bashkë dhe themi “Ti shkele ligjin”, atëherë nuk do të ketë më probleme.” (Tiranë, Mashkull)*

- *“Ligji nuk zbatohet sepse ka një nivel të lartë korrupsioni. Duhet të ndiqet deri në fund zbatimi i ligjit. Deri në pikën e fundit, aty ku ndodh ngjarja, pasi kjo nuk shkon, kjo vetëm thuhet në parlament, shkruhet nëpër letra dhe nuk zbatohet.”(Shkodër, Femër)*

Një numër pjesëmarrësish pranojnë se vetë qytetarët e ushqejnë korrupsionin dhe se duhet të fillojnë nga vetja, duke ndaluar këtë praktikë dhe duke raportuar rastet e korrupsionit.

- *“Ti [I drejtohet një pjesëmarrëseje tjetër nga sektori i shëndetësisë] e ke ushqyer vetë ti, e ke ushqyer vetë korrupsionin, atëherë që s’kishte ajo, e le në fund fare, le të ngordhte ajo tjetra derisa ti vinte radha, le të vdesi.” (Fier, Femër)*
- *“Për mendimin tim, ne jemi ata që i lëmë gjërat të ndodhin. Paguajmë lekë për të nxjerrë fëmijët tanë nga burgu. Për mendimin tim duhet ti lëmë aty, si ndëshkim.” (Tiranë, Mashkull)*
- *“Unë marr insulinë për burrin. Në fillim burri im i jepte dy mijë lekë. Ajo më pas filloi të kërkonte vetë dy mijë lekë. Një ditë, unë shkova dhe kërkova insulinë dhe më kërkoi para. Më tha se nëse nuk e paguaj, insulina do më kushtojë dhe më shumë. Duhet të ndërjegjësohemi dhe të mos japim më para.” (Fier, Femër)*
- *“Ne e pranojmë [korrupsionin]. Jemi të parët që duam korrupsion. Ti shkon në shkollë dhe paguan. Edhe për provime. Pagan se nuk je i aftë të kalosh vetë.” (Shkodër, Femër)*
- *“Po se ka raste që na intereson korrupsioni në një anë, te shëndetësia s’të intereson po ama te policia te intereson, se unë punoj taksist, shkoj e marr mall në Mal të Zi e duhet me kalu menjëherë dhe të intereson korrupsioni që mos të denoncojë policia.” (Shkodër, Mashkull)*
- *“Edhe vete jemi një çikë neve, hajde ti japim një çikë. Veja me burrin unë dhe i thosha jepi një pesçe se ai nuk ta thotë atë sëmundje që ke po nuk i dhe.” (Fier, Femër)*

## **SHËNDETËSIA DHE ARSIMI**

Sektorët e shëndetësisë dhe arsimit u kritikuan gjerësisht nga pjesëmarrësit, kryesisht për mungesë efikasiteti dhe për korrupsion.

Sektori i shëndetësisë shihet nga pjesëmarrësit si një nga sektorët më të korruptuar dhe jo-funksionalë në vend. Krahasuar me vitin e shkuar, pjesëmarrësit shprehën edhe më shumë pakënaqësi me standardet e ulëta, investimet e pakëta, dhe veçanërisht nivelin e lartë të korrupsionit. Një numër i vogël pjesëmarrësish gjithashtu përmendin se procedurat për marrjen e librezës të sigurimit shëndetësor për spitalet publike janë shumë të komplikuar, të vështira dhe se kërkojnë shumë kohë. Disa prej tyre përmendin gjithashtu që të papunët nuk mund të përfitojnë sigurim shëndetësor publik.

- *“Shëndetësia është shtetërore, ka mjekë, që nga doktori më i thjeshtë deri tek drejtori, është i punësuar dhe ka rrogën. Tani sikur larg qoftë sëmuresh, po s’pate lek në xhep atje s’të zë njëri me dorë. Nëse nuk ke 10 mijë lekë ai s’të kap me dorë.” (Fier, Mashkull)*
- *“[Korrupsioni nis nga] kontakti i parë. Kontakti i parë ka të bëjë. Që në mënyrën sesi të trajton infermierja, mos shko deri te mjeku, është në mënyre skandaloze. Ti duhet të*

*paguash që te roja që të hysh brenda, pastaj procedurat vazhdojnë. Unë mendoj që këto raste duhen denoncuar.” (Elbasan, Femër)*

- *“Nuk të kërkojnë [para], por ti prit kot, prit shumë derisa të thotë në fund, çfarë do këtu, shtyhu më tutje, etj. Këto janë format e ndryshme të presionit psikologjik.” (Shkodër, Femër)*
- *“Sepse ka dhe një problem me sigurimet shëndetësore. Për të nxjerrë librezën shëndetësore duhet të bësh një rrugë të gjatë në institucionet, në rast se je i papunë nuk e merr. Dhe qytetari për të shmangur këtë duhet të regjistrohet tek zyra e punës si i papunë. Të presësh dy muaj sa zyra e punës të kontrollojë nëse je ti.” (Fier, Mashkull)*
- *“Shëndetësia më keq s’ka ku të shkojë. Unë kam ken me babën, që më ka vdekë para ca muajsh, dhe korrupsion i gjallë. Masandej s’ të fut doktori po s’i dhe lekë, lëre që as bëhet fjalë me të ndihmu. Dhe si bënin, as një serum as një gjilpërë dhe për një muaj i kam blerë ilaçet, vetë.” (Shkodër, Mashkull)*
- *“Fillon një operacion dhe mjeku në spitalin e shtetit të kërkon hapur: kaq du unë, kaq do infermierja, dhe kjo besoj u ka ndodhur të gjithëve.” (Shkodër, Femër)*
- *“Është e tmerrshme [shëndetësia], ne kemi paguar taksat dhe të gjitha dhe akoma nuk mund të bëjmë një analizë të thjeshtë të gjakut falas.” (Tiranë, Femër)*

Pjesëmarrësit në të gjitha qarqet, në mënyrë të vazhdueshme, ngritën si mangësi kryesore të sistemit të shëndetësisë çështjen e mungesës së ilaçeve në spitalet shtetërore, atë të mjekëve që punojnë në spitalet shtetërore dhe ndajnë kohën e tyre edhe në klinika private, si dhe marrëveshjet midis mjekëve dhe farmacistëve ku doktorët iu kërkojnë pacientëve të paguajnë për mjekimin e tyre. Pjesëmarrësit pranojnë se marrin shërbim më të mirë në sektorin shëndetësor privat, por se pak prej tyre mund ta përballojnë atë.

- *“Mos të lejohen mjekët që gjatë orarit, 8-orarëshit të punës së shtetit, ai të shkojë ta mbylli dhe të shkojë te klinika private. Do të hapesh klinike private, ok jam dakord, po jo në mënyrë që të jesh gjatë orarit të punës [ku duhet të jenë të disponueshëm në klinikat shtetërore].” (Elbasan, Femër)*
- *“Problem janë dhe mjekët, të gjithë që punojnë në shtet punojnë dhe në privat. Në shtet pjesa më e madhe nuk ta bëjnë shërbimin dhe të thonë emrin e një klinike private që të japin shërbim më të mirë.” (Tiranë, Femër)*
- *“Ti nuk mund të shkosh te privati se nuk ke para. Ti nuk shkon te shtetërori se nuk i zë besë. Ata të japin rezultatet e analizave dhe analizat nuk ti japin.” (Fier, Femër)*
- *“Janë dhe lidhjet me farmacitë, ku mjeku thotë do shkosh në këtë farmaci për të marrë ilaçet se janë cilësore. Janë të lidhur me njëri tjetrin dhe marrin përqindjet.” (Fier, Femër)*
- *“Po edhe këto aparaturat, skaner, e çfarë janë këto pajisjet e spitalit shtetëror [kanë nevojë për përmirësim]. S’ke pse te shkosh ta bësh., shkova te spitali ushtarak lexonte atje “skaneri” dhe më pastaj “skaneri nuk punon”. Ishte dhoma e skanerit dhe skaneri nuk punonte. Mora në telefon për t’u ankuar te ministri i shëndetësisë, dhe nuk ekzistonte ai numri. Dhe pse duhet ta bëjnë.” (Elbasan, Femër)*

Shumë pjesëmarrës besojnë se një mbikëqyrje më e madhe nga ana e qeverisë dhe e institucioneve përgjegjëse, investimet në infrastrukturë si edhe një rritje e pagave për personelin mjekësor do të përmirësonin gjendjen e këtij sektori.

- *“Te mjeku duhet të jetë më shumë syri për t’ia rritur rrogën, se ka në dorë jetën e njeriut dhe ato për shembull në rastet kur ngelesh keq në maternitet, nuk e kapnin një grua me dore vetëm sepse ajo nuk kishte lekë. Ajo i thoshte, po e them tamam siç i thoshte “Do shes vëçin aman vetëm nusen shiko thoshte”. (Elbasan, Femër)*
- *Unë mendoj që është dhe një arsye tjetër, pagat e ulëta të doktorëve dhe infermiereve i bëjnë ata të sillen si po sillen. Se p.sh. në spital privat nuk kërkojnë lekë ekstra se pagat janë më të mira. Në privat ti e zë vendin e punës pa paguar kurse në shtet është bërë ankand dhe vendi i punës.” (Tiranë, Femër)*
- *“Me bë me i shtu rrogat në shëndetësi, në arsim, pasi rritja e rrogave ndikon, pasi kur ka rrogën e vogël në spital ai është i detyruar me punu se ka një fëmijë dhe duhet me e shkollu.” (Shkodër, Femër)*
- *“dhe në shëndetësi t’i thotë [qeveria] atij doktorit që ti e ke rrogën 100.000 dhe nëse ti vjedh atëherë s’do punosh më.” (Tiranë, Mashkull)*

Pothuajse të gjithë pjesëmarrësit mendojnë se standardet e arsimit janë shumë të ulëta. Korrupsioni shihet si gjerësisht i përhapur, një opinion i shprehur dhe në hulumtimin e vitit të kaluar. Kjo veçanërisht kur flitet për mësuesit e shkollave publike që ofrojnë kurse private kundrejt një tarife, në vend të ofrimit të cilësisë në mësimdhënie gjatë orëve të mësimin në shkolla. Ata besojnë se kërkohet konkurrencë e ndershme për vendet e punës për mësuesit, investime në infrastrukturë, kritere më strikte për hyrjen në universitete, si edhe më shumë mbikëqyrje nga qeveria. Qytetarët vlerësojnë planin e qeverisë për të investuar më shumë në arsimin profesional dhe shumica e tyre e shohin këtë formë arsimimi si një nga zgjidhjet për uljen e korrupsionit në këtë sektor, që ul njëkohësisht dhe papunësinë te të rinjtë.

- *“Shkolla shtetërore ka qenë jashtë standardit si i thonë.” (Fier, Femër)*
- *“Për mendimin tim, këtu në Tiranë standardet janë më të larta në provimet e maturës, ndërsa në qytete të tjera standardet e vlerësimit janë me të vërtetë të ulëta. Kjo e bën të vështirë për një student të Tiranës që të fitojë të drejtën e studimit në një universitet të mirë, ndërsa studentët që vinë nga rrethet e tjera, të cilët duhet të kenë një mesatare më të ulët, vijnë në Tiranë me rezultate të larta” (Tiranë, Femër)*
- *“Nuk është normale që mësuesja t’u kërkojë studentëve të shkojnë në kurse private. Djalin e kam 11 vjeç dhe kërkon mësuesja kurs në matematikë, kurse në anglisht,[pas orarit të shkollës, kundrejt pagesës] atëherë përse paguhet kjo mësuese? Kur prindi po e çon në shkollë çfarë duhet ti mësojë ajo mësuese, kur ti mua më kërkon që sille në kurse private [ekstra].” (Elbasan, Femër)*
- *“Goca ime është në klasë të parë me një klasë me 42 nxënës. Shkova e kapa mësuesen dhe më tha nuk është e përqendruar. I thashë goça ime te shtëpia është shumë e përqendruar. Tha nuk kam se çfarë të bëj, jemi 40 e ca nxënës.” (Tiranë, Mashkull)*
- *“Dje isha unë tek drejtorja arsimore të punësoja nusen time që është mësuese. Me vjen keq më tha, ik e hajde kur të bësh 5 mijë euro.” (Fier, Mashkull)*
- *“Unë mendoj kështu, që Edi Rama ka mbështetur shumë edhe shkollat profesionale dhe shpresoj që ky është një element që në të ardhmen do ndikojë shumë duke qenë se të gjithë nxënësit, po të gjithë pa pikë diference, si ai që ka mbaruar me rezultate të mira shkollën e mesme si ai që ka mbaruar me zor të madh dhe që mund të ketë ngelur shkojnë të gjithë në universitet, dalin të gjithë nga universiteti përmes korrupsionit. Ata që kanë mesatare më të ulët duhet të shkojnë nëpër shkolla profesionale.” (Elbasan, Femër)*

- “Arsimi ka rënë, unë kam 28 vjet që punoj në arsim dhe jo për të thënë atë që mund ta marrin e ta shfrytëzojnë politikisht një diçka por.... ” (Shkodër, Femër)
- “Ligjet janë zgjidhja e të gjitha gjërave, edhe puna e kurseve[nga mësuesit në vend që të zhvillojnë mësimin siç duhet në klasë]duhet të rregullohet me ligj. Si një ekonomist të ushtrojë profesionin e tij jashtë orarit të punës së shtetit, edhe një mësues i cili do të zhvillojë kurse private duhet të ketë licencë private, të regjistrohet, të paguajë tatime dhe në momentin që firmoset kontrata me mësuesit duhet të përcaktohen këto.” (Korçë, Femër)
- “Sepse është kjo pra mania që thamë, që secili do nga një diplomë të shkollës së lartë. Do kritere universiteti, jo hajde tashi more notën këtu, dha provimin atje dhe del që i pranojnë për të konkurruar për në universitete. (Elbasan, Mashkull)
- “Nuk ka çuna të rinj që duan të bëjnë punë të këtilla[zanati] për 2 mijë lekë. Ata i quajnë punë të rëndomta sepse kanë diplomën. Profesionet sot janë të nevojshme, duke filluar që nga saldatori te hidrauliku.” (Elbasan, Mashkull)
- “Është problemi i ngrohjes. Shkojnë në shkollë nxënësit dhe kthehen përsëri se nuk i qasin ngaqë nuk ka ngrohje.” (Korçë, Mashkull)
- “Punësimi në sistemin e arsimit është i kalbur nga korrupsioni. Kushton rreth 7000 euro për tu punësuar dhe një i ri që sapo ka mbaruar shkollën e lartë ku ti gjejë, aq më tepër prindërit. Kam vajzën unë që ka mbaruar shkollën e lartë dhe as e mendoj ndonjëherë që të gjej punë për gjuhë-letërsi sepse unë s’i kam 7000 euro. Ky është tregu.” (Shkodër, Femër)

## **SIGURIA PUBLIKE**

Ashtu si vitin e kaluar, siguria publike përbën shqetësim për shumicën e pjesëmarrësve në të gjitha qarqet, me përjashtim të Korçës. Rritja e numrit të vjedhjeve, grabitjeve dhe vrasjeve kanë çuar në rritjen e nivelit të shqetësimit të qytetarëve. Pjesëmarrësit e perceptojnë rritjen e shkallës së kriminalitetit si pasojë të situatës së keqe ekonomike si edhe papunësisë së lartë, veçanërisht të rinjtë.

- “Ka ditë që kam frikë të kthehem në shtëpi kur është errësirë, sepse ka një rrugicë të pandriçuar dhe të ngushtë te lagjia ime ku rrinë çuna që pinë dhe hashash, dhe kam frikë të kaloj vetëm. Më duhet t’i them burrit që të vijë të më marrë”. (Tiranë, Femër)
- “Shkollat nuk janë të sigurt, as shtëpitë. Problemet ekonomike i sjellin këto gjëra.”(Tiranë, Femër)
- “[A ndiheni të sigurt?]: jo duhet të rri vetë natën te dyqani, s’e lë dot mbyllur se e vjedhin.” (Shkodër, Mashkull)
- “Ne i kemi bërë të gjithë shtëpitë me dyer të blinduara, me tre brava. Dikur në pallatin tim, vite më parë rrinin dyert hapura, sot kyçen dhe disa herë.” (Tiranë, Mashkull)
- “Rend do të thotë nëse ke shërbime, nëse ti sheh dikë në vështirësi mund të marrësh numrin e emergjencës, ata vinë menjëherë. Kjo s’ndodh asnjëherë tani.” ( Shkodër, Femër)
- “Siguri s’ka. Kur mbyll portën me çelës, e mbyll se siguri nuk ke. Ke komshiun por prapë e mbyll derën me çelës se kanë fëmijë nga 17-18 vjeç po janë, s’mendojnë nga ajo që nuk

*kanë çfarë të humbasin, janë pa kontrollin e familjes dhe duke hyrë në ndonjë shtëpi për të marrë edhe një shishe, i duket sikur e siguroi jetën.”(Elbasan, Femër)*

Disa pjesëmarrës besojnë se në forcat e policisë janë bërë reforma dhe thonë se ato kanë përmirësuar punën e policisë, por se rezultatet – ulja e nivelit të kriminalitetit – mbeten për t’u parë në vazhdim.

- *Grup diskutimi meshkujsh në Tiranë:*
  - Pjesëmarrësi i parë: *“Ka më shumë policë në rrugë. Ka një tendencë për mirë” (Tiranë, Mashkull)*
  - Pjesëmarrësi i dytë: *“Tani nuk është se ka më shumë policë në rrugë por të vijmë më shpejt kur ke nevojë, se më parë vinin pas 20 minutash, pasi ishte bërë vrasja”. (Tiranë, Mashkull)*
- *“Jam e lumtur me reformat në polici, pasi varem gjithmonë, kur ke një hall merr atë, se të paktën ka filluar të reagojë, sepse thoshte me rroftë rroba se nuk kam fuqinë në dorë, ndërsa tani ka ndryshuar.” (Korçë, Femër)*
- *“Duket sikur ka më shumë policë në pamje të parë”. (Fier, Mashkull)*
- *“Për çështjen e rendit, unë e kam vërtetuar vetë, unë kam pasur një problem dhe kur shkoja në polici po mos kishe dikë mik nuk ta hapte asnjë derën, kurse tani, kur telefonova policinë ata erdhën shumë shpejt.” (Korçë, Femër)*

## **ÇËSHTJET RAJONALE**

Shqetësimet specifike rajonale (përveç çështjeve ekonomike) që u shprehën nga pjesëmarrësit variojnë nga ndotja e ambientit në Elbasan dhe Fier, te mungesa e infrastrukturës dhe investimeve të përshtatshme, sidomos në zonat rurale edhe në bujqësi, në Shkodër dhe Korçë. Fermerët në këto zona thonë se mungesa e infrastrukturës dhe e tregjeve për produktet e tyre kanë pasur ndikim negativ në prodhimin e tyre bujqësor, duke çuar në varfërimin e mëtejshëm të familjeve fermere.

- *“Për mbetjet spitalore e kisha fjalën. Mbetjet spitalore nuk duhet të grumbullohen e digjen dhe hidhen në vende të caktuara bashkë me plehrat e qytetit sepse ndotet ambienti..” (Elbasan, Femër)*
- *“Çështja e kombinatit. Instancat, personat që janë ulur në karrige kanë përgjegjësi. Ligji është ligj. Pra çështja është këtu, fauna, mjedisi, zotërinjtë që kane ligjin duhet të jenë të prerë. Duhet të jenë të saktë. Në pushtet je në pushtet, në zyrë je në zyrë.” (Elbasan, Mashkull)*
- *“Le të supozojmë më minimalen, pastërtinë për mjedisin, në fshatra s’ka kosha fare.” (Shkodër, Mashkull)*
- *“E ka pasur dhe e ka [Elbasani problemin e ndotjes]. Elbasani ka dy kombine. Ka një kombinat që e dinë të gjithë, ka dhe një kombinat që quhet fushë plehrash.” (Elbasan, Mashkull)*
- *“Të mbajmë pastër ambientin, mendoj se është gjëja më kryesore.” (Fier, Mashkull)*
- *“Ti vaditje 3 muaj por ato të ardhura nuk të dilnin për të shlyer energjinë elektrike, për pastrimin e kanaleve, jo më të paguajë ruajtjen gjatë tërë vitit me 3 turne. Shteti nuk e garantoi këtë punë, dmth që ta ruante. Tani ka mbetur vetëm vendi atje. Asgjë s’ka*



*mbetur. Bilës edhe tullat i prenë dhe i kanë marrë.”*  
(Korçë, Mashkull)

- *“Me frutat psh kanë thënë [qeveria] që kur të bëhen, do ju ndihmojmë ti transportoni dhe ti gjeni treg shitje, por tani s’ka ndodhur, s’u kanë bërë gjë.”* (Shkodër, Mashkull)
- *“Ne prodhojmë mallin, dhe s’ka treg dhe e shesim me një çmim qesharak”* (Shkodër, Mashkull)
- *“Bashkia hiç, p.sh në rrugën tonë është hapur mbi 5 herë një kanal ...imagjinoje ta kesh asfaltuar, ta kesh rregulluar, ta kesh inauguruar dhe të hapet një herë, më pas të hapet prapë së dyti, të hapet prapë së treti ...imagjinoje se çfarë fshihet pas kësaj”* (Shkodër, Femër)
- *“Fshatarin për asnjë gjë s’po e ndihmon. As për vaditje... dhe ndihmë ekonomike jepet shumë pak. Për shembull gjërat duam t’i sigurojmë por s’i sigurojmë dot. Se aq kemi në – 5 dynym tokë. Nuk mundesh edhe ta sigurosh edhe të jetosh.”* (Korçë, Mashkull)

### III INTEGRIMI EUROPIAN

Shumica e pjesëmarrësve janë në favor të integrimit evropian. Sikurse edhe vitin e shkuar, qytetarët e shohin integrimin evropian të lidhur me shtimin e investimeve në vend, duke përmirësuar në këtë mënyrë cilësinë e tyre të jetesës. Qytetarët e perceptojnë BE-në si një mjet për të përmirësuar monitorimin e punës së qeverisë dhe forcuar shtetin e së drejtës. Besohet se anëtarësimi çon në një sistem arsimor dhe shëndetësor më të mirë si edhe në uljen e korrupsionit. Megjithatë, qytetarët janë të vetëdijshëm se anëtarësimi në BE sjell edhe më shumë përgjegjësi dhe detyrime – si për qytetarët ashtu dhe për shtetin. Nga ana e disavantazheve, qytetarët besojnë se anëtarësia në BE mund të çojë në rritjen e çmimeve dhe taksave, si edhe në konkurrencë më të madhe në tregun e BE-së.

- *“Nëse ne marrim statusin kandidat do të thotë që Shqipëria ka përparuar. Do të ketë më pak korrupsion, etj”* (Elbasan, Femër)
- *“Hyrja në BE të kufizon në shumë drejtime, të cilat mendoj se janë të mira.. Duke filluar që nga legjislacionet dhe vendimet e ndryshme ekonomike etj-etj. Them se kjo do të sjellë jo vetëm rritje dhe mirëqenies por dhe shumë ndryshime në legjislacionin tonë, në ndjekjen e problemeve; si të thuash, ne do të dënojmë fajtorët.”* (Elbasan, Mashkull)
- *“Do të thoja se anëtarësimi në BE[do të uli korrupsionin], duke filluar nga politika që do të ndiqej sepse vetë në BE, të gjithë vendet që janë në BE ndiqen dhe monitorohen nga BE. Një gjë që bën BE-ja është krijimi i politikave shumë efektive të cilat të japin një ndihmesë në gjithçka që bën ti si vend.”* (Fier, Mashkull)
- *“Në një farë mënyre është e rëndësishme sepse do vihen ca rregulla dhe nuk do lëvizet as andej dhe as këtej, as korrupsion, asgjë nuk do bëhet”.* (Fier, Femër)
- *“Populli përfiton sepse do të ndihet si qytetar evropian, dhe do të mund të gjejnë punë vetë”.* (Tiranë, Mashkull)
- *“Normal që është e rëndësishme[anëtarësimi në BE] se do të marrim më shumë ndihmë, duke filluar në radhë të parë me luftën kundër varfërisë”.* (Korçë, Femër)
- *“Për mendimin tim është edhe privilegj edhe detyrim. Privilegji është që ke të drejtë të shkosh ku të duash, ke mundësi të shkosh të punosh ku të duash, ti bashkohesh*

komunitetit evropian. Po ka edhe ca detyrime të tjera si për shembull për doganat, që thotë ai të mos futet malli i huaj derisa të shisni produktet vendase”. (Korçë, Mashkull)

- “Me i pasë dokumentet ne do të punojmë kudo, dhe unë me pasë dokumentet italiane mund të punoja dhe një vit më shumë” (Shkodër, Mashkull)
- “Keq jemi[lidhur me progresin drejt BE-së]; jemi shumë mbrapa, gjithmonë të fundit. Me futboll të fundit, me këtë të fundit, me këtë të fundit... Edhe ne themi se më mirë do bëhet. Nuk bëhet.” (Tiranë, Mashkull)
- “Për mendimin tim, do të vinin investitorë të huaj nga jashtë e do të hapte një ndërmarrje të re, dhe do ishte dhe ai dhe ne më të sigurt.” (Fier, Femër)
- “Rinia punësohet më shumë jashtë shtetit e tu u punësu edhe ekonomia e Shqipërisë rritet.” (Shkodër, Femër)
- [Shqipëria do të ketë] “Edhe zhvillimi intelektual, sepse hapja, përvojat, shkëmbimet, shkollimet, njohja me zhvillimet e vendeve të tjera”. (Shkodër, Femër)

## IV PRITSHMËRITE PËR QEVERINË E RE

Pritshmëritë e pjesëmarrësve për qeverinë dhe vlerësimi për iniciativat e saj të para janë përgjithësisht pozitive dhe shfaqin njëfarë optimizmi të matur për të ardhmen. Ata pranojnë se mund të jetë tepër herët për të gjykuar iniciativat e reja, por përmendin pa vështirësi disa nga masat konkrete të cilat i mirëpresin në parim: mbyllja e pikave të basteve dhe kazinove, shembja e ndërtimeve pa leje, anulimi i amendamenteve të qeverisë së mëparshme në ligjin e menaxhimit të integruar të mbetjeve - me anë të së cilave ishte lejuar importimi i mbeturinave, taksimi progresiv, dhe fushata për luftën kundër korrupsionit.

- “Unë mendoj se nuk mund të gjykohet në dy muaj. Unë kam diskutuar me shumë njerëz dhe mendojmë se nuk mund të gjykohet për dy muaj tashti, sepse janë në pushtet vetëm prej tre muajsh.” (Korçë, Mashkull)
- “Mua më duken sikur janë të gjithë aktivë [qeveria e re], janë forcë e re dhe besoj se nuk i pengon njeri.” (Fier, Femër)
- “Arsimi, e ndërroi atë të drejtorisë arsimore, ka bërë shumë mirë. Ka vendosur një njeri të mirë që e meriton atë pozicion.” (Fier, Femër)
- “Për policinë psh. [është përmirësuar] arritën që i kapën të tërë ata të burgosurit.” (Fier, Femër)
- “Mbyllja e kazinove ishte një gjë shumë e mirë që bënë. Burrat rrinin që në mëngjes deri në darkë.” (Fier, Femër)
- “Dakord jemi me doganat. Kam vënë re që kanë mbledhur shumë taksë gjatë tre muajve të fundit. Unë s’e kam dëgjuar ndonjëherë që brenda tre muajve të mbledhë kaq miliardë lekë ajo e doganave.” (Elbasan, Mashkull)
- “Kanë vendosur tip spiunësh, që të sigurohen që marrin doktorët apo jo lekë, tip spiunash domethënë, te shëndetësia. Di që është hapur dhe një faqe zyrtare për të denoncuar rastet e korrupsionit.” (Elbasan, Femër)
- “Një gjë tjetër pozitive është mbyllja e kazinove. Të gjithë e dimë në Shqipëri që ka një ligj për t’i çuar larg zonave të banuara.” (Elbasan, Mashkull)
- “Ka kapur[qeveria e re] pikat më kyçe, ka kapur drejtësinë, shëndetësinë, etj.” (Shkodër, Femër)

- *"Duket sikur janë marrë shumë me korrupsionin, vetëm kjo duket si pozitive, po të tjerat nuk më duken ndonjë gjë kshu...."* (Tiranë, Mashkull)
- *"Zbatimi sa më parë i taksës progresive. Unë jam pro se një biznes i vogël që është aty me një të punësuar i paguan kaq bashkisë, kaq qeverisë."* (Shkodër, Femër)

Shumë pjesëmarrës, në mënyrë të shpeshtë, shprehën mungesë sigurie për zbatimin me efikasitet dhe/ose transparencë të reformave të lartpërmendura. Një shembull që disa prej tyre sollën ishte rihapja e pikave të lojërave të fatit menjëherë pas inspektimeve të para, gjë të cilës nuk i japin dot shpjegim. Të tjerë e perceptojnë shembjen e ndërtimeve pa leje si arbitrarë, selektive dhe me një kosto të lartë. Disa prej pjesëmarrësve gjithashtu sollën ndërmend premtimin parazgjedhor të qeverisë për legalizimin e pronave joformale; në këmbim ata kërkojnë që këto veprime të kryhen me transparencë dhe që qeveria të parandalojë dhe ndëshkojë ndërtimet e reja pa leje. Dhe ndërsa qytetarët vlerësojnë lart punësimin sipas meritës në administratën publike, ata shprehen skeptikë për gjasat e zhdukjes së favorizimit politik.

- *"Për shembull, në lagjen time nga 5 kazino, tre janë akoma hapur."* (Tiranë, Femër)
- *[Për mbylljen e kazinove] "Ajo është gjë e mirë. Ato të voglat, si ato që kisha unë i mbyllen. Kishim 4-5 makina. Po ata që kanë 24? Ata janë akoma aty. Si është e mundur që kazinotë e mëdhaja nuk e dëmtokan familjen? Ata që duan të luajnë do ikin nga imja tek ato të mëdhajat."* (Tiranë, Mashkull)
- *"Ishte gjë shumë e mirë që qeveria i mbylli [lojërat e fatit]. Po janë hapur prapë. Nuk zgjati më shumë se tre ditë."* (Korçë, Femër)
- *Ata [pronarët e kazinove] paguan lekë dhe u hapën prapë. Kjo është ajo që s'më pëlqen tek qeveritë. Zakonisht, e para gjë që bëjnë [qeveritë] është që sulmojnë kazinotë dhe korrupsionin."* (Elbasan, Femër)
- *"Unë nuk jam dakord me prishjen e ndërtimeve pa leje, sepse qeveria duhet të vendosi gjoba që të rrisi buxhetin e shtetit."* (Korçë, Femër)
- *"Një gjë nuk me pëlqen tek kjo prishja: që ka kosto."* (Tiranë, Femër)
- *"Prishja e ndërtimeve pa leje është gjë e mirë, po duhet ti prishin të gjitha jo vetëm disa"* (Elbasan, Femër)
- *"Pse po prishin vetëm ato te PD? Po ato të PS?"* (Korçë, Femër)
- *"I kane shpallur luftë korrupsionit, po a do realizohet nuk e dimë."* (Shkodër, Femër)
- *"Korrupsioni është i kudondodhur, është e kotë të bëjmë sikur po e luftojmë. Shumë zhurmë për asgjë. Edhe përprjekja për të akuzuar dhe arrestuar njerëz bëhet vetëm për të tërhequr vëmendjen. Me bën çudi fakti që ata që janë të korruptuar thonë që do luftojmë korrupsionin. Si do ta luftosh korrupsionin? Do futësh veten në burg?"* (Tiranë, Mashkull)
- *"Na kane premtuar që s'do paguajmë për të legalizuar shtëpitë dhe se procesi do përfundonte brenda vitit siç tha kryeministri."* (Elbasan, Femër)
- *"Siç e përmendëm më herët, korrupsioni. Janë bërë shumë diskutime të mira për këtë gjë por akoma s'kemi parë një shembull. Po flasim për ish ministrin e mbrojtjes por po presim për rezultatet. Shpresojmë të mos ndodhë si me Gerdecin ku çështja humbi nëpër gjykata."* (Fier, Mashkull)

Pjesëmarrësit ngritën çështjen e taksimit në pothuajse në të gjitha grupet e diskutimit. Shumica e pjesëmarrësve dukej se pajtoheshin me taksimin progresiv të prezantuar rishtazi nga qeveria,

pavarësisht faktit se shumica e tyre nuk ishin plotësisht të qartë mbi mënyrën se si sistemi i ri supozohet të funksionojë. Disa pjesëmarrës ngritën shqetësimin se rritja e taksave për biznesin mund të sjellë shkurtime të vendeve të punës në terma më afatgjatë.

- [*“Ju personalisht, përfitoni nga taksimi progresiv?”*] *“Po. Tash nëse kemi qenë duke paguar 10 % tani do paguajmë 3 %.”* (Shkodër, femër)
- *“Qeveria duhet ta taksojë biznesin e madh më shumë për arsye se marzhi i fitimit është më i lartë. Këtu duhet të fokusohet më tepër qeveria.”* (Fier, mashkull)
- *“Ja për shembull marrim taksën. Domethënë, thanë që do i hiqen taksat biznesit të vogël, por taksat kanë filluar të rriten si për bizneset e mëdha.”* (Elbasan, femër)
- *“Gjë tjetër që do shtoja është dhe sistemi i taksave. Le shumë për të dëshiruar. Unë mendoj se biznesit të vogël duhet t’i jepet një dorë në lidhje me fuqizimin e të gjithë ekonomisë. Biznesi i vogël duhet të ketë një taksë më të ulët.”* (Fier, mashkull)
- *“Bizneset e vogla janë rënduar shumë nga taksat që janë rritur, sa vjen edhe po rriten.”* (Korçë, femër)
- *“Sa më shumë të kesh, aq më shumë do të paguash.”* (Korçë, mashkull)
- *“Të gjithë dinë ta drejtojnë biznesin e tyre, por sa e ngrejnë si biznes, barra e taksave të larta bëhet e papërbalueshme. Siç ishte ky lajmi i fundit që do ta kalojnë taksën e biznesit tek shtëpitë.”* (Tiranë, mashkull)
- *“Mbrëmë që dëgjoja këta të biznesit. Thoshte që qeveria do t’i taksojë akoma më shumë kompanitë e mëdha. Ndërsa ngrinte problemin që nëse taksohen më shumë nuk do të kenë mundësinë të investojnë dhe rrjedhimisht të hapin dhe vende pune.”* (Korçë, mashkull)

Disa pjesëmarrës kritikuan punën e qeverisë gjatë tre muajve të parë të saj, duke përmendur këtu mungesën e transparencës mbi nismat apo vendimet e reja, përfshirë komunikimin e vendimit në lidhje me shkatërrimin e armëve kimike siriane në Shqipëri. Diskutimi mbi këtë çështje dëshmoi për përshtjellim nëse ky ishte një vendim i mirë apo jo, kryesisht për shkak të mungesës së informacionit mbi atë çfarë ky angazhim do t’i sillte Shqipërisë. Disa pjesëmarrës të tjerë u ankuan rreth propozimit të qeverisë për shtyrjen e moshës së pensionit.

- *“Për sa i përket armëve kimike në Shqipëri, nuk kishte shumë informacion. Ishte e zymtë si situatë dhe nuk kishte transparencë.”* (Fier, mashkull)
- *“Për armët kimike kryeministri duhet të dilte hapur dhe të thoshte se çfarë përfitimesh kemi neve si popull, dhe çfarë pasojash kishim neve si popull.”* (Shkodër, femër)
- *“[Vendimi i qeverisë për të refuzuar armët kimike] ishte ai i duhur. Bëmë mirë që nuk i pranuan.”* (Shkodër, mashkull)
- *“[Ishte vendimi i duhur] Po drejt se sikur një pikë, kam lexuar në facebook, vdesin 24 vetë”* (Shkodër, mashkull)
- *“[Çmontimi i armëve kimike] Do të ishte mirë te ekonomia e Shqipërisë, do ishte trefishuar buxheti”* (Shkodër, mashkull)
- *“60 ose 65, të dalin më shpejt njerëzit në pension edhe futi të tjerët në punë.”* (Elbasan, mashkull)
- *“Nga 68 do ta bëjë 69. Ne jemi që tani të këputur jo më kur të shkojmë 69. Do ta bëjnë si në Greqi”* (Korçë, mashkull)

Të pyetur se cilat duhet të jenë prioritetet e qeverisë gjatë vitit të parë në pushtet – përveç shqetësimeve të sipër-përmendura në lidhje me punësimin, luftën kundër korrupsionit, zbatimin e ligjit dhe sigurimin e rendit publik – pjesëmarrësit e vunë theksin te rëndësia e vendosjes së sistemit të punësimit në administratën publike në bazë merite, si dhe te mbështetja për biznesin e vogël.

- *“Të paktën njëri pjesëtar i familjes, nëna ose babai, të jetë në punë. Në punë shteti. Por jo fare pa punë. Ka familje që janë pa punë fare.” (Fier, femër)*
- *“Unë besoj në meritokraci. Një tjetër do të ishte vendosja e kriterëve më të larta, për shembull për punësimin. Janë vendosur kriterë më të larta se më përpara. Konkretisht, studentët që kanë mbaruar një master të caktuar, kanë dalë shumë mirë, kanë mundësi për t’u punësuar, kurse më përpara edhe me mesatare shumë më të ulët janë punësuar përmes korrupsionit.” (Elbasan, femër)*
- *Grupi i fokusuar i përbërë nga gra në Elbasan:*
  - *Pjesëmarrësja e parë: “Për punën e kriterëve (për punësimet në administratën publike) kemi dëgjuar edhe për punën e këtyre pranimeve për sa u përket drejtorave dhe besoj se duhet të jetë...” (Elbasan, femër)*
  - *Pjesëmarrësja e dytë: “Asnjëherë më parë nuk është bërë në mënyrë publike, kaq transparente. Unë s’kam parë ndonjëherë që një drejtues arsimor të zgjidhej në televizion. Këto ishin konkurse që u transmetuan (në tv). Asnjëherë nuk e kam parë më përpara këtë gjë.” (Elbasan, femër)*
- *Meritokracia është zgjidhja e këtij problemi. Në rast se do të kishte meritokraci, një konkurs, ta dijë secili që punë do të fillojë ai që është i aftë për atë punë, atëherë tjetrit mendoj që do t’i lindi ideja të gjejë një zgjidhje tjetër. Sepse për kalamajtë e mi unë mendoj të shkollohen atje ku ata ndihen të aftë që nesër të konkurrojnë.” (Elbasan, Mashkull)*
- *“Viti i parë (përparësitë e qeverisë duhet të jenë), 1.Korrupsioni, 2.Meritokracia në emërime, 3.Pronat. Po të rregullojë këto për një vit, shihe ti c’bëhet” (Elbasan, Mashkull)*
- *“Qeveria e re premtoi se do të futen me konkurs të tërë ose do të konvertohet diploma me profesionin që t’i bën.” (Tiranë, femër)*
- *“Gazsjellësi TAP po na nxori, që të punësojë njerëzit.” (Tiranë, mashkull)*
- *“Të mos vendosin njerëz me bindje partiake në vende pune.” (Shkodër, femër)*
- *“Dhe një gjë pozitive e kësaj qeverie që kemi dëgjuar është që nuk do angazhohen nxënësit e shkollave, mësuesit në aktivitete politike.” (Shkodër, femër)*
- *“Nëse sot kryeministri është duke punësuar njerëz përmes konkursit është gjëja më e mirë.” (Shkodër, femër)*
- *“Duhet të nxisin bizneset e huaja të vijnë në Shqipëri dhe të paguajnë taksën e sheshtë.” (Tiranë, mashkull)*
- *“Për mendimin tim (qeveria) t’ua heqë borxhin bizneseve që të marrin frymë, se dhe biznesi punon.” (Shkodër, femër)*
- *“T’i kushtohet çikë kujdes shëndetësisë për mua do bënte mirë. Të fillojë të rregullojë godinat njëherë”. (Tiranë, mashkull)*
- *“Fushat ku ata mund të japin fryte tani janë rendi dhe drejtësia” (Tiranë, mashkull)*

## V POLITIKA

### SITUATA POLITIKE DHE PARTITË POLITIKE

Pjesëmarrësit në diskutim shprehin mosbesim të përgjithshëm te politika dhe partitë politike dhe janë skeptikë në ekzistencën e ndonjëre partie politike që është e interesuar të zgjidhë problemet e qytetarëve. Të gjitha partitë politike shihen si njësoj fajtoresh dhe asnjëra nuk dallohet si e orientuar drejt zgjidhjes së problemeve. Ashtu si në studimin e vitit të kaluar, pjesëmarrësit shprehën se partitë politike vënë interesin e tyre para atij të qytetarit, duke dëshmuar kështu për një perceptim shkëputjeje midis “atyre” dhe “nesh”, veçanërisht në periudhat jashtë zgjedhjeve.

- *“Partitë politike janë thjesht për interesat e tyre.” (Tiranë, Femër)*
- *“Janë të gjitha njësoj.” (Tiranë, Mashkull)*
- *“Duhet të përpiqen për interesat e njerëzve dhe jo për interesat e partisë. Dhe të mos nxisin konfliktet midis njerëzve me ide të ndryshme.” (Shkodër, Femër)*
- *“Premtimet që bëjnë partitë politike janë jashtëzakonisht shumë të mëdha në krahasim me ato që mbajnë” (Fier, Mashkull)*
- *“Partitë politike janë trampolinë për të mira materiale, jo për të bërë karrierë ose për t’iu përkushtuar popullit, por thjesht trampolinë për të mirat materiale.” (Elbasan, Mashkull)*
- *“Po ka humbur besimi, se njerëzit ndryshe flasin, ndryshe bëjnë, dhe thellë thellë ndryshe mendojnë.” (Tiranë, Mashkull)*
- *“Ata njerëz që janë në politikën shqiptare, nuk i beson asnjëri sepse të dalin supermiliardera pa bërë asgjë. Dhe ti duhet t’u rrih nga mbrapa atyre, për çfarë?” (Tiranë, Mashkull)*
- *“Politika është e keqe e domosdoshme. Por kemi nevojë për ta [partitë politike] pasi ajo formon qeverinë, dhe qeveria i duhet çdo shteti.” (Korçë, Mashkull)*
- *“Bëjnë sikur na dëgjojnë vetëm gjatë fushatave. Tani nuk duan t’ia dinë.” (Fier, Mashkull)*
- *“Une mendoj që nuk kemi klasën e duhur politike. Sepse në një sistem të mirë politik, ekziston një farë marrëveshje, ndërkohë që këtu unë shoh luftë midis njeri-tjetrit. Dhe po të njëjtit njerëz vijnë gjithmonë.” (Elbasan, Femër)*

Një numër pjesëmarrësish do të donin t’i shihnin partitë politike më transparente dhe të hapura ndaj qytetarëve. Ata besojnë se procedurat e partive janë mospërfshirëse dhe se programet e partive nuk arrijnë t’i tërheqin. Ndërsa pjesëmarrësit pohojnë se politikanët trokasin shpesh në dyert e tyre gjatë fushatave elektorale, ata kanë shumë pak kontakt me ta në raste të tjera.

- *“Partitë politike janë 99% si bunker.” (Korçë, Mashkull)*
- *“Është vështirë të influencosh vendimet e partive. Anëtarësia dhe marrja në konsideratë e opinionit janë dy gjëra të ndryshme. Është e lehtë të bëhesh anëtar. Merr dokumentin e identifikimit, regjistrohesh dhe kaq. U bëre anëtar.” (Korçë, Femër)*
- *“Tre muaj para zgjedhjeve janë të hapur [partitë politike], për votat jo për idetë. Sillen sikur po u intereson për njerëzit dhe shumë gjëra të tilla. Sapo kalojnë zgjedhjet, situata ndryshon.” (Elbasan, Femër)*

- “Na thyen derën nga të trokiturit [partitë politike gjatë fushatës].” (Tiranë, Mashkull)
- “Është turp që në shoqërinë tonë nuk kemi një politikë që ka ide, gjërat normale që janë në të mirë të vendit. Ne nuk kemi një politikë të kulturuar që flet ashtu siç duhet të flasë”. (Elbasan, Femër)
- “Deputeti vjen një herë kur kërkon votat dhe pastaj vjen ti kërkojë për mandatin e dytë”. (Korçë, Mashkull)
- “Zakonisht ndodh para zgjedhjeve që të na jepet e drejta të shprehim opinionet tona.” (Korçë, Femër)
- “Ndonjëherë ti anëtarësohesh në parti sepse ke frikë për vendin e punës. Në anën tjetër, nëse një parti tjetër vjen në pushtet mund ta humbasësh vendin e punës, kështu që s’do të dalësh hapur.” (Korçë, Femër)
- “Vetëm kur ka zgjedhje [flasim me partitë]. Gjatë zgjedhjeve të gjithë vijnë të të takojnë, por kur mbarojnë zgjedhjet të gjithë zhduken dhe si gjen dot ma.” (Shkodër, Mashkull)
- “Ne duam që partitë politike të jenë transparente. Po se ne s’e dimë fare çfarë bëjnë, psh nuk e morëm vesh fare çfarë bëri Ilir Meta atëherë dhe tani si kryetar parlamenti.” (Shkodër, Mashkull)
- “Ne kërkojmë nga partitë politike që të mos vendosin biznesmenë sepse kanë konflikt interesi nëse shkojnë në parlament dhe votojnë për ligjet.” (Elbasan, Mashkull)

Disa pjesëmarrës dënojnë kthimin e partive politike në, *de facto*, agjensi punësimi për të ofruar punë në shkëmbim të votave dhe mbështetjes. Disa të tjerë duken se kanë një pikëpamje më pragmatiste dhe i shikojnë mundësitë e punësimit si arsye kryesore për angazhim politik. Pjesëmarrësit tregojnë se besohet gjerësisht se partitë politike duhet në mënyrë të drejtpërdrejtë të sigurojnë punë dhe të mira të tjera për qytetarët, kundrejt promovimit të politikave që krijojnë vende pune në tërësi. Shumë pak pjesëmarrës thanë që do të donin të angazhoheshin në politikë —përveçse nëse iu ofrohet punë apo përfitime të tjera.

- “Për shembull, një parti politike është në opozitë dhe ka një elektorat që e ndihmon. Si do ta kënaqi elektoratin? Natyrisht duke i punësuar. Dhe kjo është diçka e tmerrshme.” (Tiranë, Femër)
- “Ne nisemi gjithmonë nga ‘ça del për mua?’. Asnjëherë nuk bëjmë diçka që partia të ecë para.” (Tiranë, Femër)
- “Po personalisht jam më shumë e interesuar te punësimi, dhe gjëja e vetme që dua të di është nëse partia do të më sigurojnë një vend punë nëse votoj për të.” (Tiranë, Femër)
- “E shikojmë gjithmonë në aspektin personal. Populli nëse është në punë është ok. Kështu që, po, punësimi është gjëja kryesore që presim nga partia.” (Tiranë, Mashkull)
- “Punësimi është prioritet. Sigurisht që partia duhet të na garantojë punë. Është normale.” (Shkodër, Mashkull)
- “E përdorin [qytetarët] partinë si një mënyrë për të zënë vendin e punës, ose për të mbajtur vendin e punës.” (Fier, Femër)
- “Po që në punë shteti duhet të jesh pjesë e një partie politike, se tek privati nuk ke asnjë lloj interesi.” (Fier, Mashkull)
- Grup Diskutimi me gratë, në Elbasan:
  - Pjesëmarrësja e parë: “Ne këtu në Shqipëri të paktën e shofim partinë politike si një shpresë. Pse e shofim si një shpresë? Xhepi nuk ma mban që të paguaja për



*një vend pune. Kështu që këtu tek ne funksionon kështu: duhet që patjetër të merresh me politikën dhe e shikoj si alternativë t'i futem kësaj rruge që të punësohem.”*

- Pjesëmarrësja e dytë: *“Këto janë thjeshtë raste. Për shembull unë kam raste në fisin tim. [I afërm] u mor me PD-në dhe gjeti punë.”*
- Pjesëmarrësja e tretë: *“Po, pra. Ka edhe në fisin tim që u mor me LSI-në sepse i premtuan vend pune dhe nuk e rregulluan.”*
- Pjesëmarrësja e parë: *“Si ka mundësi sepse LSI-ja nuk lë njeri pa futur në punë. Sot edhe diploma të mos kesh LSI-ja të fut në punë.”*

Shumica e pjesëmarrësve kërkojnë që politikanët të mbajnë më shumë përgjegjësi për performancën e tyre në periudhat midis zgjedhjeve. Mbajtja e premtimeve ishte absolutisht një nga kërkesat që pjesëmarrësit në të gjitha grupet përmendën më shpesh si pritshmëri për partitë politike. Shumë diskutues presin që partitë politike të dëgjojnë dhe të këshillohen me qytetarët në mënyrë që të ofrojnë zgjidhje të shëndosha politikëbërjeje në fusha të ndryshme si ekonomia, shëndetësia, drejtësia, rendi publik, e të tjera.

- *“[Çfarë prisni nga partitë politike?] Që të bëjnë ato që thonë! Të merren me drejtësinë dhe shëndetësinë.” (Tiranë, Mashkull)*
- *“Po për të dëgjuar edhe dëgjojnë, po varet sa bëjnë më pas. Ata premtojnë, por nuk i mbajnë premtimet.” (Fier, Femër)*
- *“Të më krijojë mua besimin që për ato që thotë, i bën.” (Fier, Mashkull)*
- *“Të mbajnë premtimet dhe të mos bëjnë premtime të mëdhaja.” (Shkodër, Mashkull)*
- *“Të mbajnë premtimet dhe të zbatojnë planet. S’ka kuptim të flasim për ta nëse devijojnë nga planet e tyre.” (Korçë, Femër)*
- *“Partia politike për mendimin tim duhet të bëj politikën ekonomike të një vendi. Kjo është detyra e saj kryesore. Dhe kjo që thonë këta, që të mbajë rregullin dhe qetësinë” (Korçë, Mashkull)*
- *“Ata duhet të dëgjojnë mendimin e njerëzve, të pyesin anëtarët dhe të mos të vendosin vetë dhe pastaj të flasin në emër të anëtareve. Të paktën ata duhet të dëgjojnë opinionin e elektoratit.” (Korçë, Femër)*
- *“Ato [partitë politike] duhet të dëgjojnë ato që kam për të thënë. Çfarëdo lloj problemi të kem! Por se sa dëgjojnë, është çështje që ha diskutim.” (Fier, Mashkull)*

Pyetjes mbi cilësitë e një lideri ideal, pjesëmarrësit i përgjigjen me pasjen e vlerave personale si të qenit i/e drejtë, përgjegjshmëria, ndershmëria, besnikëria, vullneti për të dëgjuar njerëzit, të qenit i hapur ndaj kritikave, modestia, vendosmëria dhe vizioni. Një numër pjesëmarrësish besojnë se një lider i mirë duhet të vlerësojë dhe të reflektojë vlera familjare. Përveç cilësive personale, një nivel i lartë arsimimi u përmend shpesh si një element i rëndësishëm që karakterizon një lider të mirë. Shumica e diskutuesve, siç vihet re edhe nga pjesë të tjera të diskutimeve, dëshirojnë të kenë një lider që mban premtimet, edhe pse duket se mendojnë që llogaridhënia e një lideri është një cilësi e veçantë më shumë se sa një normë e pritshme.

- *“Një lider duhet të jetë i drejtë dhe të mos shkelë ligjet. Të dëgjojë dhe të veprojë.” (Tiranë, Femër)*
- *“Të ndryshonte pak raportin midis të thënit dhe të bërit”. (Tiranë, Mashkull)*



- “Ai/ajo duhet ta respektojë kundërshtarin”. (Korçë, Mashkull)
- “Ai/ajo duhet të jetë një grua/burrë vizionar”. (Korçë, Mashkull)
- “Të jetë i përgatitur, s’bëhet fjalë, sepse për shembull të më çosh mua atje s’e bej dot, të drejtoj Shqipërinë. Po të jetë me 4 klasë ai, me shkollë nate ku do ta çosh?” (Fier, Femër)
- “Duhet të jetë besnik, dhe familjar.” (Fier, Mashkull)
- “Të mbajë premtimet e tij apo saja.” (Fier, Mashkull)

## **PRITSHMËRITË PËR OPOZITËN**

Shumica e pjesëmarrësve presin një opozitë efikase që propozon zgjidhje alternative dhe që mbështet zgjidhjet e propozuara nga qeveria kur ato zgjidhin problemet dhe janë në interes të qytetarëve. Pjesëmarrësit nuk mendojnë se opozita aktuale duhet të përqendrohet te armiqësitë personale dhe partiake apo të mbajë qëndrim pengues ndaj çdo veprimi dhe propozimi të qeverisë. Ata besojnë se një nga rolet kyçe të opozitës duhet të jetë vëmendja ndaj qeverisë dhe vendimeve të saj, duke e mbajtur atë përgjegjëse për përmbushjen e premtimeve elektorale dhe duke denoncuar korrupsionin.

- “Opozita ka për detyrë kryesore të vendosë presion tek qeveria dhe të sigurohet që ajo të përmbushi premtimet që ka bërë.” (Korçë, Mashkull)
- “Opozita duhet të kundërshtojë vendimet e qeverisë vetëm në rastet kur është e arsyeshme, në të kundërt është e kotë.” (Tiranë, Femër)
- “Opozita duhet të denoncojë pjesëtarët e qeverisë, ministrat. Ajo është një punë që unë s’e bëj dot, por deputetët mundën. Ata kanë më shumë mundësi për t’i investiguar këto gjera.” (Fier, Mashkull)
- “Opozita ka një rast të mirë tani. Pavarësisht kush është në krye të saj, ai person duhet të ketë objektivat e qarta nëse dëshiron të bëjë një rimëkëmbje të ngadaltë. Duhet stimuluar konkurrenca brenda partisë. Dhe kur themi konkurrencë, duhet të jetë konkurrencë e ndershme dhe jo grumbuj të afërmish dhe bandash që vendosin. Opozita duhet të distancohet nga gabimet e veta.” (Elbasan, Mashkull)
- “Opozita duhet të bashkëpunojë me qeverinë në mënyrë që vendi të eci përpara. Kjo duhet të ndodhë sa më shumë të jetë e mundur.” (Elbasan, Femër)
- “Opozita duhet të kapi gabimet [e qeverisë], por ato të vërtetat.” (Tiranë, Mashkull)
- “Ata [opozita] duhet të miratojnë ligjet kur janë të dobishme për njerëzit. Nuk duhet ta kundërshtojnë iniciativën vetëm se vjen nga mazhoranca.” (Elbasan, Mashkull)
- “Opozita nuk duhet të kundërshtojë apriori çdo iniciative të qeverisë. Të na thonë të vërtetën rreth vendimeve. Unë si njeri i thjeshtë që jam, acarohem kur dëgjoj lajmet në TV se s’dua të merrem fare me politikë.” (Fier, Femër)
- Nuk është efektive[opozita]. Po mundohen të diskutojnë për gjërat që i kanë bërë vetë më përpara. Thonë që po vendos militantë pozita, por ata çfarë kanë bërë ? Ti e ke bërë këtë për 8 vite, si mund të flasësh tani?” (Tiranë, Femër)
- “Opozita duhet të shtyjë qeverinë të ecë përpara dhe të mbajë premtimet. P.sh: Ti ke premtuar gjatë fushatës që do të ulësh taksat për biznesin e vogël; ti ke premtuar që do të rrisësh rrogat etj. (Fier, Femër)

- “Opozita është pasive deri tani por mendoj që po bën gjëra të mira. Psh, ata nuk janë kundër Evropës.” (Korçë, Mashkull)
- “Ata [opozita] duhet të ulen dhe të diskutojnë se çfarë është gjëja më e mirë për tu bërë dhe ta zbatojë atë. Nëpërmjet liderit të ri, ata [PD] po bëjnë një reformë të re. Duke qenë i ri, me reputacion të mirë dhe pozicion të mirë, presim më shumë nga ai sesa thjesht acarim, veçanërisht për sa i përket zgjedhjes së ligjëratis dhe fjalorit.” (Shkodër, Femër)

Ashtu siç shprehen për qeverinë e re, një numër i vogël pjesëmarrësish thonë që është akoma shpejt për të vlerësuar punën e opozitës dhe se roli i saj në të ardhmen është ende i paqartë. Disa madje shprehën dyshime që opozita mund të bëjë ndonjë gjë, meqë tashmë nuk është në pushtet.

- “Unë mendoj që sot për sot edhe të duan të bëjnë më shumë nuk bëjnë dot. Sepse partia që ka fituar zgjedhjet ende nuk mund të gjykohet për 3 muaj kohë, që ti shfrytëzohë të metat kjo opozitë.” (Korçë, Mashkull)
- “Është vetëm fillimi. Për mua ata duhet të bien dakord për të mirën e popullit.” (Shkodër, Mashkull)
- “S’kanë çfarë të bëjnë se kjo qeveri vetëm 3 muaj ka që ka ardhur në pushtet.” (Tiranë, Mashkull)
- “Nuk ka akoma opozitë. Është shumë shpejt për të folur.” (Tiranë, Mashkull)
- “Vëmë re që opozita veçanërisht tani nuk ndikon në vendimet e qeverisë. Ka vite që opozita nuk ndikon në vendimet e qeverisë. Ligjet krijohen dhe miratohen pavarësisht nëse ka opozitë apo jo. Është çështje respekti, se sa u dëgjohet zëri.” (Korçë, Femër)
- “Pse duhet ta kontaktoj atë [deputetin] që është në opozitë, se s’ke çë do. E kontakton atë po s’ka forcë.” (Shkodër, Mashkull)

Pjesëmarrësit mendojnë se Partia Demokratike i humbi zgjedhjet e 2013-ës pasi gjatë qeverisjes së saj dështoi në mbajtjen e disa premtimeve të rëndësishme. Pjesëmarrësit lehtësisht renditën një sërë arritjesh të rëndësishme të qeverisë së PD-së – kryesisht përmirësimet në infrastrukturë, liberalizimin e vizave, progresin drejt integritimit në BE dhe anëtarësimin në NATO – por ata gjithashtu përmendën të meta si korrupsioni, varfëria, shërbime të papërshtatshme shëndetësore dhe standarde të dobëta të projekteve në infrastrukturë.

- *Arritjet e qeverisë së mëparshme:*
  - “Liberalizimi i vizave” (Shkodër, Mashkull)
  - “Infrastruktura, tuneli.” (Elbasan, Femër)
  - “Hyrja në NATO dhe liberalizimi i vizave.” (Fier, Mashkull)
  - “Rrugët, infrastruktura, dhe kaq.” (Fier, Femër)
  - “Negociatat për anëtarësimin në BE është njëra nga meritat.” (Fier, Femër)
  - “Rrugët, liberalizimi i regjimit të vizave.” (Shkodër, Mashkull)
  - “Liberalizimi i vizave.” (Fier, Mashkull)
- “Rrugët nuk janë sipas standardeve dhe shumë prej tyre janë ndërtuar afër kanaleve të ujërave të zeza, dhe as makinat nuk kalojnë dot. Kjo është e paligjshme.” (Shkodër, Mashkull)
- “Ata [PD] janë në opozitë. E dini pse? Sepse nuk mbajtën premtimet.” (Korçë, Mashkull)
- “Ajo rruga [Elbasan-Tiranë] nuk është e sigurt. U bë vetëm sepse duhet të përrurohej para zgjedhjeve. Por nuk është e sigurt.” (Elbasan, Femër)

- “Korrupsionin në shëndetësi dhe mungesa e ilaçeve në spitalet publike [ishin mangësitë e qeverisë Berisha].” (Elbasan, Femër)
- “Infrastruktura ishte një gjë e mirë, por situata ekonomike ishte një dështim, kështu që për çfarë ta dua infrastrukturën?” (Tiranë, Femër)
- “Mungesa e mbështetjes për të varfrit [nën qeverisjen e PD]” (Fier, Mashkull)

## PARLAMENTI

Qëndrimet e pjesëmarrësve ndaj parlamentit pasqyrojnë qëndrimin e tyre ndaj politikës. Reagimet e para në lidhje me parlamentin janë shpesh negative dhe refuzuese. Shumica e pjesëmarrësve nuk e kuptojnë si parlamenti funksionon apo se si ai lidhet me jetën e tyre të përditshme. Një numër pjesëmarrësish mendojnë se anëtarët e parlamentit janë të shkëputur dhe të pandërgjegjshëm për problemet e qytetarëve dhe kushteve në zonat e tyre, dhe një numër i konsiderueshëm pjesëmarrësish e pranojnë se nuk e dinë kush është përfaqësuesi i tyre i zgjedhur. Ata besojnë se deputetët përfaqësojnë interesat e partive të tyre politike dhe jo të qytetarëve. Pjesëmarrësit kërkojnë që të gjithë deputetët të demonstrojnë se njohin problemet e tyre të përditshme.

- “Politika është po e njëjta, parlamenti është po i njëjti, në debate, gjithmonë opozita është kundër pozitës, nuk ka ndonjë gjë të re në parlament.” (Shkodër, Femër)
- “(Parlamenti) është si Portokallia në versionin origjinal.” (Tiranë, Mashkull)
- “Listat e mbyllura janë për mua vdekje e jetës politike në Shqipëri.” (Elbasan, Mashkull)
- “Duke qenë se anëtarët e parlamentit nuk zgjidhen nga qytetarët, atëherë nuk përfaqësojnë qytetarët. Ata përfaqësojnë kryetarin e partisë. Nuk kam fare besim tek ata.” (Tiranë, Femër)
- “Jo. Ata parlamentarë janë këtu e 20 vjet. Ato muhabete bëjnë, ato llafe. Është e kotë.” (Fier, Mashkull)
- “[A ju përfaqësojnë ju deputet e parlamentit?] Absolutisht jo. Përfaqësojnë interesat e veta” (Tiranë, Mashkull)
- “Jo jo se nuk na përmendin [qytetarët], vetëm në një seancë të parë na kanë përmendur dhe pastaj s’janë ndjerë më për ne” (Shkodër, Mashkull)
- “Ata bëhen bashkë (deputetët e parlamentit) dhe japin licensa, të miqve...Se kshu bëjnë ata.” (Tiranë, Mashkull)
- “Në fushata elektorale i takon të gjithë por kur mbaron fushata asnjë.” (Shkodër, Femër)
- “Një deputet vjen vetëm për të të kërkuar votën.. I sheh vetëm në TV [deputetët].” (Korçë, Mashkull)
- “Është më e lehtë për të kontaktuar Edi Ramën apo Sali Berishën nëpër rrjetet sociale se sa deputetin e zonës tënde. Kanë ndryshuar dhe numrat që mos t’i bezdisin.” (Korçë, Femër)
- “Unë s’e kam idenë fare kë kemi deputet të zonës.” (Fier, Mashkull)

Pjesëmarrësit kanë qëndrime përgjithësisht negative ndaj politikës, por gjithsesi kërkojnë të kenë kontakte më zyrtare dhe të rregullta me deputetët në periudhat jo-zgjedhore. Disa sugjerojnë që

deputetët të hapin zyra në zonat e tyre, të cilat të funksionojnë si vend takimi për të diskutuar problemet me të cilat qytetarët përballen. Një numër pjesëmarrësish thonë se nuk e kanë idenë si të mund të kontaktojnë me përfaqësuesit e zonave të tyre gjatë periudhave jo-zgjedhore, por se janë të interesuar të kenë një kontakt të tillë. Vetëm pak pjesëmarrës thonë se dinë apo kanë mënyra për të kontaktuar me deputetët, si p.sh nëpërmjet email-it, zyrave të deputetëve–aty ku ekzistojnë, si edhe nëpërmjet të njohurve të përbashkët.

- *“Në momentin që deputetet kishin një zyrë pranë bashkive apo qarqeve atëherë ato përballëshin me të gjitha problemet, me ecjen problematike, pavarësisht sa aftësi kishin për t’i zgjidhur këto probleme. Duke ditur që ato po u mërzhitesh jeta, miratuan atë aty në parlament edhe i mbyllën të gjitha këto zyrat. Do të thotë që meqenëse këto deputetët nuk kishin kontakte të drejtpërdrejta me votuesin, ai nuk ndjen asnjë lloj përgjegjësie për këtë popull.”* ( Elbasan, Mashkull)
- *“S’ka asnjëri zyre përveç Edit [Rama]. Deputeti këtu në Fier s’ka asnjë zyrë.”* (Fier, Mashkull)
- *“Ne s’kemi një zyrë të mirëfilltë që të shkojmë ti takojmë.”* (Shkodër, Femër)
- *“Dimë se kë të kontaktojmë po nuk dimë se si.”* (Fier, Mashkull)
- *“[Mund ti kontaktojmë deputetët] tek selitë e partive.”* (Korçë, Mashkull)
- *“Me sa di unë, janë deputetët e zonave tek të cilët mund të drejtohesh.”* (Tiranë, Femër)

Përgjigjet e pyetjes se pse do t’i drejtoheshin një anëtari të parlamentit shpesh pasqyrojnë po ato çështje që ata duan që qeveria të adresojë. Shumica e pjesëmarrësve përmendin punësimin si çështjen më prioritare për të diskutuar me një deputet, pasuar nga çështje të tjera të një rëndësie specifike për komunitetet e tyre vendore, si p.sh midis çështjeve të tjera, riparimi i sistemeve të vaditjes, rikonstruktimi i rrugëve, parandalimi ose pakësimi i ndërprerjeve të shpeshta të energjisë elektrike dhe siguria publike.

- *“Për rrugët. Në lagjen time për shembull është bërë premtim që do të rregullohej rruga por në fakt nuk është rregulluar.”* (Elbasan, Femër)
- *“Për punësimin. Ka influencë, është deputet i zonës. Ka dhënë premtime... apo janë premtime boshe ato që u dhanë. Për shembull, një premtim që u dha gjatë fushatës ishte që do të hapej një rrobaqepësi për tu punësuar disa gra.”* (Elbasan, Femër)
- *“Ja unë do i thosha (deputetit) që jam kaq veta në shtëpi, jam burrë e grua, goca më ka mbaruar shkollën e lartë, ka mbaruar me 8.2, urdhëro zotëri pse nuk i gjen një vend pune?”* (Fier, Femër)
- *“Unë do të diskutoja edhe për këtë. Ajo ura e Fierit është nisur, ka nja gati 8 vjet, ky punoi. Nuk e di se kush e ka tani, ndoshta e ka bashkia.”* (Fier, Femër)
- *“Tani unë kam një gjë. Nesër ne do dalim në pension, vjetërsi pune nuk kemi, gjë s’kemi. Si do i bëhet?”* (Fier, Femër)
- *“Siç thamë për rregullin, dhe shitja e prodhimeve në tregje.”* (Shkodër, Femër)
- *“Për ekonominë, rininë, rrugët, taksat që na marrin kot se ne paguajmë shumë taksa.”* (Shkodër, Femër)
- *“Për punësimin, për takime të shpeshta me elektoratin.”* (Shkodër, Femër)
- *“Vaditjen e tokave, kanalizimet”* (Shkodër, Mashkull)
- *“Energjinë elektrike, që na ikin dritat pa arsye.”* (Shkodër, Mashkull)

- *“Për çështje të lidhura me sigurinë.” (Tiranë, Mashkull)*

### **ZGJEDHJET PARLAMENTARE 2013**

Pjesëmarrësit në grupet e fokusuara i konsiderojnë zgjedhjet parlamentare të qershorit 2013 si pozitive dhe relativisht më të mira se proceset e mëparshme zgjedhore në vend. Kjo përshtypje e përgjithshme bazohet në përshtypjet e pjesëmarrësve se procesi ishte i qetë, i drejtë dhe i menaxhuar më mirë se në të shkuarën. Pjesëmarrësit gjithashtu komentuan pjesëmarrjen më të lartë në zgjedhje dhe rezultatin e qartë e të pakontestuar.

- *“Kësaj radhe ishin të qeta (zgjedhjet), pa shumë incidente.” (Tiranë, Femër)*
- *“(Zgjedhjet) Shumë më të qeta, nuk kishte radhë, ishin shumë qendra votimi.” (Tiranë, Femër)*
- *“Po kishte një lirshmëri (në zgjedhje), nuk ishte imponim, presion...” (Korçë, Mashkull)*
- *“Pjesëmarrja ishte vërtetë e mirë. Elektorati ishte shumë më i ndërgjegjësuar dhe doli të votonte.” (Shkodër, Femër)*
- *“Ishte [procesi zgjedhor] shumë herë më i mirë. Ishte i qetë, pa probleme madhore.” (Tiranë, Mashkull).*
- *“Ata [numëruesit e votave] lexuan vetëm çfarë është në kuti. Kishte vetëm manipulime të vogla.” (Fier, Mashkull)*
- *“[Procesi Zgjedhor] ishte normal. Ishte sipas rregullave. Çdo gjë ishte më e qetë.” (Korçë, Femër)*
- *“Unë mendoj se qe një proces zgjedhor shumë i drejtë. Nuk pati korrupsion.” (Elbasan, Femër)*
- *“Pati pak progres. Të paktën për herë të parë rezultatet e zgjedhjeve treguan që politikanët janë ndërgjegjësuar pak a shumë.” (Elbasan, Mashkull)*
- *“Ishin perfekte. Zgjedhjet po përmirësohen vazhdimisht.” (Fier, Mashkull)*
- *“S’të thoshte njëri votën ma jep mua, jepja kujt të duash...” (Fier, Femër)*
- *“[Zgjedhjet ishin] më të mirat deri tani.” (Korçë, Mashkull)*
- *“Nuk pati probleme gjatë shpalljes së rezultatit. Rezultati ishte i qartë” (Korçë, Mashkull)*

Disa pjesëmarrës mbeten skeptikë për zgjedhjet në përgjithësi. Besimi te administrimi i zgjedhjeve nuk është rifituar plotësisht. Disa pjesëmarrës pohojnë se ka pasur blerje votash gjatë zgjedhjeve, dhe shumica e këtyre thonë se blerja e votave ka karakterizuar të gjitha partitë njëjloj. Disa pjesëmarrës në secilin grup thonë se nuk kanë votuar fare, për shkak të mungesës së alternativave të qenësishme. Ky grup mendon se procesi zgjedhor nuk ka qenë më i mirë se ato të viteve të shkuara, pasi citojnë se presioni ndaj votuesve dhe shit-blerja e votave kanë qenë pjesë integrale e këtij cikli zgjedhor.

- *“Kjo KQZ-ja e kaluar kishte katër (nga 7 anëtarë). Çfarë besimi do kishim ne? Dua të them se ishte vetëm një forcë politike sepse të tjerat u tërhoqën. Ishte vetëm e djathta. Ishte [rezultati i qartë i zgjedhjeve] vetëm verdikti i popullit që ...” (Elbasan, Femër)*

- “Nga të gjitha palët (janë blerë vota). Te komuniteti rom kemi dëgjuar që ka blerje votash për 1 thes miell, e të tilla gjëra.” (Tiranë, Femër)
- “Dhe nuk ka rëndësi me çfarë partie je, kushdo që u ofron çfarë kanë nevojë ata, ajo parti e merr votën.” (Tiranë, Femër)
- “Edhe me 7000 mijë lekë të vjetra e kanë shitur, se prej fukarallëkut, edhe e kanë fotografuar, ky fenomen ka qenë i pranishëm edhe këtë vit.” (Shkodër, Femër)
- “Kam unë motrën që punon në uzinë mekanike në Patos dhe ia ka dhënë asaj partie që i ka thënë që voto të rrish në punë.” (Fier, Femër)
- “Merr njërin [person] dhe jepi lekët. Pastaj, ai kryesori i familjes do marri në telefon familjarët e tij dhe do thojë të votojnë për atë.” (Tiranë, Mashkull)
- “Gjithkush ka blerë vota, dhe vetëm janë hedhë lekë, kush ka mundur, se unë ta shes ty votën dhe vetë votoj për kë të du.” (Shkodër, Mashkull)
- “Unë kam një kushëri. Atij i dhanë 30 mijë lekë të vjetra për të votuar për një x parti; bashkë me gruan i thonë 60.” (Korçë, Mashkull)
- “Unë nuk shkoj fare për të votuar. [Pse?] Sepse s’kam për kë të votoj. Kur të dali dikush që e meriton [do votoj].” (Tiranë, Mashkull)

## VI GRATË NË POLITIKË

Pavarësisht moshës apo gjinisë, shumica e pjesëmarrësve janë të mendimit se duhet të ketë më shumë gra në politikë. Kur u pyetën sa gra deputete ka në kuvend, mendimi i tyre i përgjithshëm ishte se numri aktual i grave në kuvend është shumë më i madh se sa në legjislaturat e mëparshme dhe u habitën të mësonin se përfaqësimi i grave ka ndryshuar shumë pak<sup>2</sup>. Ky reagim mendohet të jetë për shkak të rritjes së madhe të numrit të grave të emëruara në postet ministrore, që pjesëmarrësit e përkthyen në mandate në kuvend. Pjesëmarrësit në të gjitha grupet dhe qarqet specifike lëvduan qeverinë për emërimin e një numri të paprecedentë femrash në postet ministrore. Ata në përgjithësi argumentuan se duhet të ketë më shumë gra në politikë pasi ato janë menaxhere më të mira, kanë rezultate më të larta pune, janë më diplomate, më pak të korruptuara dhe të lidhura më ngushtë me shqetësimet e zgjedhësve. Pjesëmarrësit i konsiderojnë gratë si më të orientuara drejt problemeve dhe politikave dhe besojnë se femrat janë më të afta të nxisin politika që trajtojnë shqetësimet e qytetarëve. Ndaj, ata theksojnë se përfshirja e perspektivave të grave në zgjidhjen e problemeve kontribuon në gjetjen e zgjidhjeve më të qëndrueshme dhe afatgjata.

- “Një grua komunikon më mirë.” (Shkodër, Mashkull)
- “Janë diplomate të mëdhaja, më të mençme.” (Shkodër, Femër)
- “Femrat janë më pak të korruptueshme.” (Elbasan, Femër)
- “Ndjehem mirë (për femrat në politikë) se në Europë i kemi parë avokate, gjykatëse, police etj.” (Shkodër, Mashkull)

<sup>2</sup>Në kohën e mbajtjes së grupeve të fokusuara, kishte vetëm 25 femra (18.5%) në kuvend, pra vetëm dy më shumë se përbërja e mëparshme e kuvendit. Disa deputetë u emëruan për të drejtuar ministritë e kabinetit, e si rrjedhojë hoqën dorë nga mandati i deputetit dhe numri i deputeteve gra në datën 28 dhjetor 2013 u rrit në 28. Që nga ajo kohë, numri ka rënë në 26, si pasojë e emërimeve dhe dorëheqjeve të disa grave nga dy mandate, specifikisht Lezhë (2) and Durrës (4). Këto mandate në fund u morën nga kolegë meshkuj në parti.

- “Gratë sjellin kulturën.” (Shkodër, Mashkull)
- “Mendoj se femra punon më shumë.” (Fier, Femër)
- “Femrat nga natyra janë më të fisme. Se burrin në fund të fundit e merr i jep një kafe kurse me femrën është ndryshe. Është më e vështirë për t’i korruptuar. Ato janë të pastra.” (Elbasan, Mashkull)
- “Kam dëgjuar një emision televiziv se cilët korruptohen më lehtë burrat apo gratë, dhe ata thanë burrat sepse kanë më shumë kërkesa.” (Elbasan, Femër)
- “Na duhen më shumë gra në politikë sepse ku ka gra ka progres. Në këtë rast nëse do kishim më shumë gra debati do të ishte më i mirë.” (Elbasan, Mashkull)
- “Margaret Thatcher ka thënë se “Nëse doni të bëni diçka jepjani një femre. Nëse doni të dëgjoni diçka jepjani një burri.” (Elbasan, Femër)
- “Është shumë e rëndësishme të kesh më shumë gra në politikë. Sjell politika të reja.” (Elbasan, Mashkull)
- “Është e rëndësishme sepse një grua do t’i shikonte politikat sociale nga një këndvështrim tjetër.” (Korçë, Femër)
- “Gratë janë më kërkuese dhe më pak të manipuluar.” (Korçë, Mashkull)
- “Kemi nevojë për më shumë gra në politikë sepse gruaja është më strikte në vendimmarrje.” (Tiranë, Femër)
- “Sipas disa statistikave femrat janë më pak të korruptuara se meshkujt.” (Tiranë, Femër)
- “Aftësia e saj për përfaqësim më të denjë të zgjedhësve është me rëndësi.” (Elbasan, Femër)
- “Të gjithë ata që shpresojnë tek miku apo tek leku druhen shumë kur një femër vjen në pushtet sepse e kanë shumë më të vështirë për t’i gjetur anën.” (Elbasan, Femër)
- “Mendoj se ka më shumë femra [parlamenti].” (Tiranë, Femër)
- “[Qeveria e re] ka caktuar femra. Femrat janë të afta, jo të korruptueshme dhe më njerëzore.” (Fier, Femër)
- “Unë do përkrahja femrat, diferenca është thjesht se cili është më i zoti në argumente dhe për të mbushur mendjen.” (Shkodër, Femër)
- “Nëse një grua dhe një burrë kanë të njëjtat aftësi, kanë mbaruar të dy shkollën, dhe janë në të njëjtën moshë, unë do votoja për gruan.” (Korçë, Mashkull)
- “Nëse bëjnë punën si duhet, nuk ka rëndësi nëse është femër apo mashkull.” (Fier, Femër)

Ashtu si në gjetjet e vitit të kaluar, pjesëmarrësit theksojnë faktin se femrat përballen me vështirësi më të mëdha se meshkujt për t’u angazhuar në politikë, dhe se ato janë ende të nën-përfaqësuar, kryesisht për shkak të detyrimeve të shumta familjare dhe shoqërore që iu ngarkohen grave. Një numër pjesëmarrësish theksojnë se gratë nuk angazhohen politikisht për shkak të normave patriarkale dominuese në shoqëri. Disa pjesëmarrëse femra theksuan se komunitetet me tradita të rrënjosura thellë dhe mentalitete patriarkale shpesh i pengojnë femrat që jetojnë në këto zona të angazhohen aktivisht në politikë.

- “Mundësitë mund t’i kenë të njëjta në letër (femrat), por aktualisht nuk besoj se kanë mundësi të njëjta. Një mashkull e ka më të lehtë të gjejë disa miq për ta ndihmuar atë për një post. Mendoj se është më e vështirë për një grua të ftojë shoqet e saj për mbështetje votash.” (Tiranë, Mashkull)

- “Burrat e kanë më të thjeshtë. Burrat shoqërohen më shumë njëri me tjetrin, gratë nuk takohen shpesh.” (Korçë, Mashkull)
- “Për shkak të mentalitetit negativ, një grua do të merrte mjaft epitete nëse do të vendoste të garonte si kandidatë.” (Tiranë, Femër)
- “Një femër është më e ngarkuar se një mashkull. Ajo është nënë, edukatore, pastruese, kuzhinierë.” (Shkodër, Femër)
- “Gratë nuk kanë të njëjtat mundësi si burrat.” (Elbasan, Femër)
- “Kjo është një shoqëri maskiliste. Sado që ne e ngremë zërin që të ketë më shumë femra prapë s’ka. Problemi qëndron edhe tek besimi. Sido që të jetë njerëzit besojnë më shumë tek një burrë.” (Elbasan, Femra)
- “Burrat mund të drejtojnë më mirë se gratë pasi ato janë më të preokupuara me shtëpinë, me fëmijët. Burrat janë më të lirë në këtë drejtim.” (Korçë, Femër)
- “Besimin e bazojnë tek fuqia fizike.” (Elbasan, Femër)
- “Për shembull, nëse do të garonte një zonjë për deputete, unë do të votoja për të. Po se është kjo ideja në mentalitetin shqiptar, burrat janë më të zotë.” (Fier Femër)
- “Unë mendoj se kur është në kandidim një mashkull dhe një femër, të gjithë ata janë më të predispozuar për të votuar për mashkullin.” (Fier, Femër)
- “Është si në një familje. Në shtëpi figura e babait është ai që komandon. Ai kujdeset për familjen.” (Elbasan, Femër)
- “Sepse mentaliteti qëndron në atë që nëse një grua merret me politikë njerëzit fillojnë e flasin keq për të.” (Shkodër, Femër)
- “Ndonjëherë femrat japin përshtypjen sikur nuk kanë shumë mundësi për të zgjidhur probleme. Duket sikur nëse është femër ajo nuk do e çojë punën deri në fund. Nga ana tjetër një mashkull e çon punën deri në fund.” (Elbasan, Femër)
- “Të vendoset besimi te femrat, sepse njerëzit nuk besojnë te ato” (Shkodër, Femër)

Një numër më i vogël pjesëmarrësish meshkuj në disa nga grupet e diskutimit u shprehën se nën-përfaqësimi i grave në partitë politike reflekton, për fat të keq, situatën e përgjithshme në shoqëri. Këta pjesëmarrës mendojnë se femrat hasin pengesa institucionale për të arritur në role drejtuese dhe vendimmarrëse në partitë politike, të cilat janë edhe mënyra kryesore e arritjes të pozicioneve të përfaqësimit të zgjedhur. Ata fajësojnë partitë politike, dhe specifikisht kryetarët e tyre, për procedura të mbyllura për përzgjedhjen e kandidatëve, çka e bën veçanërisht të vështirë zgjedhjen e grave në pozicione përfaqësuese.

- “Grave duhet t’u jepet më shumë hapësirë në partitë politike.” (Korçë, Mashkull)
- “Asnjë nga partitë nuk i ka realizuar kuotat gjinore. Minimumi ishte 30% por ata se kanë arritur akoma.” (Elbasan, Mashkull)
- “Ana negative e këtyre zgjedhjeve është se ata bëjnë lista partish dhe fusin kë të duan. Sipas meje unë dua të votoj për kandidatin dhe jo për listën.” (Elbasan, Mashkull)
- “Këtu bëhet ndryshimi [se si përbëhen listat e kandidatëve], plus që konkurrenca brenda partive është e egër dhe është më e vështirë për femrat që të ecin përpara.” (Elbasan, Mashkull)

Në disa pak raste, kryesisht te pjesëmarrësit meshkuj, mbizotëronin qëndrimet konservatore rreth angazhimit të femrave në jetën publike dhe politike. Këta pjesëmarrës mendojnë se gratë kanë



mundësi të njëjta me meshkujt në politikë dhe siç rezultoi edhe nga studimi i vitit të kaluar, një numër i vogël pjesëmarrësish, kryesisht meshkuj, nuk e mbështesin pjesëmarrjen e grave në jetën publike dhe politike, duke e parë rolin primar të femrave në kujdestarinë e shtëpisë.

- “Pak rëndësi ka. Një grua më tepër apo katër më tepër nuk ndryshojnë gjë.” (Tiranë, Mashkull)  
“Faktikisht gratë na prishin punë, e kupton?[i drejtohet moderatorit]. Mos e keq drejto bisedën [duke pyetur për gratë]. Asnjëherë në historinë Shqiptare gratë kanë bërë më mirë. Gruaja del, në lokale epo dale tani po enët kush do ti lajë burri?” (Tiranë, Mashkull)
- “Gratë nuk janë efiçente. Unë votoj për burra sepse ata kanë më shumë autoritet se gratë.” (Tiranë, Mashkull)
- “Një femër egërsohet vetë nga ambjenti [politik], kupton? Është shumë mirë që janë aty por problemi është që po u egërsua femra atëherë bëhet shumë herë më e keqe.” (Tiranë, Mashkull)
- “Për një arsye [burrat janë më të përshtatshëm për të bërë politikë], ata lëvizin më shumë, kanë më shumë njohje. Shoqëria shqiptare është e tillë.” (Korçë, Mashkull)
- “Jo nuk janë sepse grave i duhet të rrinë më shumë në shtëpi me familjen.” (Korçë, Mashkull)
- “Ajo gatuan, ajo bën punët e shtëpisë.” (Korçë, Mashkull)
- “Ne nuk e njohim (gruan e zgjedhur në parlament), të paktën unë, sepse nuk është zgjedhur drejtpërdrejt. Është ashtu siç tha zotëria. Është e rekomanduar nga partia.” (Korçë, Mashkull)
- “Mashkulli është lider i vërtetë, i jep drejtim gjërave. Femra është e lëkundur, është fleksibël.” (Fier, Mashkull)

Kur u pyetën nëse kanë dijeni për ekzistencën e strukturave apo organizatave të veçanta për gratë në partitë politike dhe shoqërinë civile, disa pjesëmarrës u përgjigjën pozitivisht. Ndërmjet atyre pjesëmarrësve që ishin në dijeni për forumet e grave brenda partive politike, shumë pak besojnë se ato janë vendi i përshtatshëm për të diskutuar çështjet e grave dhe se çështjet dhe diskutimet e ngritura në nivelin e forumeve të grave duhet të ngrihen në nivele më të larta vendimmarrëse. Megjithatë, shumica e pjesëmarrësve që ishin në dijeni të forumeve të grave brenda partive besojnë se, edhe pse forumet e grave ekzistojnë formalisht, ato aktualisht nuk kanë asnjë funksion praktik. Akoma më shumë pjesëmarrës shprehen se kanë shumë pak informacion rreth ekzistencës së forumeve të grave apo organizatave qytetare që mbështesin çështjet e grave. Pjesëmarrësit meshkuj në veçanti, nuk kishin dijeni për praninë e strukturave të grave brenda partive. Në përgjithësi, pjesëmarrësit shfaqin pak njohuri për rolin që këto organizata mund të luajnë në partitë politike apo në promovimin e përfaqësimit të grave në përgjithësi. Ata besojnë se nëse janë të mirë-organizuara këto struktura mund të ngrenë shqetësimet e grave në parlament.

- “Mendoj se është diçka pozitive të ketë edhe një vend ku të flasësh për problemet që kanë gratë; për çfarë i shqetëson ato; për të ngritur zërin. Duke e ngritur zërin tek ky forum ai do ta ngrejë edhe më lart.” (Elbasan, Femër)
- “Është e rëndësishme të ngrihen diskutime sepse pastaj mund ti ngrenë diskutimet më lart.” (Fier, Femër)

- “Në këto forume[të Grave] ka shumë gra po kur vjen çështja për deputete në parlament nuk e di se si zgjidhen”. (Tiranë, Femër)
- “Mendoj se forumet e grave janë vetëm formalitet e nuk zgjidhin ndonjë gjë. I ngrenë problemet po nuk bëjnë asgjë, kështu që mendoj se është thjesht një formalitet.” (Fier, Femër)
- “Po ekzistojnë, mbliidhen por çfarë bëjnë?” (Fier, Femër)
- “Po nuk kanë pushtet për të ndryshuar gjë.” (Fier, Femër)
- “A mund të bëjnë diçka për dhunën në familje?” (Fier, Femër)

Në përgjithësi pjesëmarrësit kanë informacion të kufizuar për punën e organizatave të shoqërisë civile të cilat punojnë për çështjet e grave dhe përmendin vetëm grupe që punojnë kundër dhunës në familje dhe në mbështetje të grave të komunitetit rom.

- “Nuk dimë ndonjë emër të veçantë por është një OJF e cila punon për të drejtat e grave të Komunitetit Rom.” (Tiranë, Mashkull)
- “Dimë për një shoqatë që është këtu në Elbasan, e cila merret me dhunën ndaj grave.” (Elbasan, Femër)
- “Për shembull qendrat për dhunën ndaj grave nuk janë funksionale. Njoh shumë persona që kërkojnë ndihmë nga këto qendra dhe ata thonë që nuk ka fonde. Ose për shembull gratë e dhunuara i trajtojnë si psh kurse parukerie dhe u ofrojnë strehim.” (Elbasan, Femër)
- “Kam qenë në një trajnim që organizohej nga një shoqatë që luftonte dhunën ndaj grave.” (Tiranë, Femër)

Edhe pse e krijuar vetëm një muaj para mbajtjes së diskutimeve përmes grupeve të fokusuara, kur u pyetën për Aleancën e Grave Deputete –një grupim i grave në Parlamentin e Shqipërisë – një numër pjesëmarrësish thanë se kishin dijeni për ekzistencën e saj dhe se ai mund të ishte një forum i mirë për të promovuar përfshirjen e shqetësimeve të grave në agjendën parlamentare, si dhe për të ofruar zgjidhje për ato shqetësime. Një numër i vogël pjesëmarrësish theksuan se Aleanca duhet të përqendrohet më shumë në promovimin e çështjeve të barazisë gjinore në arenën publike dhe sugjeruan se ajo duhet të nxisë marrjen e masave konkrete në luftën kundër dhunës ndaj grave. Ata gjithashtu besojnë se Aleanca mund të ndihmojë në uljen e tenseve gjatë seancave parlamentare.

- “Meqenëse gratë janë minorancë në parlament, duke bashkuar zërat do të dëgjohen më shumë. Dua të them se, pavarësisht krahut politik të cilit i përkasin, së bashku ato mund të ngrenë zërin për problemet që kanë gratë në përgjithësi.” (Elbasan, Femër)
- “Dëgjuam në lajme se u zgjodh Mesila Doda përfaqësuese e grave të parlamentit.” (Tiranë, Mashkull)
- “Sot dëgjojmë mjaft për dhunën ndaj grave, e cila ka pasur një rritje drastike. Dhe nuk kemi më vetëm raste tipike që rrahu gruan që ishte normal, por madje edhe kur janë shtatzënë. Ata janë të dhunshëm me fëmijët e tyre... Dëgjova një rast kur një burrë kishte rrahur fëmijën e vogël 2 vjeç. Uroj që Aleanca [e ligjvënësve gra] të ngrejë zërin për këtë çështje.” (Elbasan, Femër)
- “Të ngrihet zëri më shumë rreth kësaj çështje... të aprovohen ligje më të ashpra për dhunën ndaj grave.” (Elbasan, Femër)

- “Është gjë e mirë që kanë krijuar [Aleancën] sepse kështu do munden të mbrojnë të drejtat e tyre.” (Tiranë, Mashkull)
- “Atë e themeluan [Aleancën] me qëllim që të mbrojnë të drejtat e grave të dhunuara.” (Tiranë, Mashkull)
- “[Aleanca] është kontingjent i PD-së. PD e përdor për të afruar sa më shumë gra.” (Tiranë, Mashkull)
- “Është një shenjë e emancipimit të grave. Një mesazh pozitiv që tregon se megjithëse ideologjitë janë të ndara prapë ne mund të bashkohemi për çështje të rëndësishme mbi problemet e grave.” (Shkodër, Femër)

## VII AKTIVIZMI QYTETAR

**Pjesëmarrësit në përgjithësi pranojnë që nuk janë shumë aktivë në komunitetet e tyre. Ata pohojnë se ndjenja e komunitetit në Shqipëri, ose më saktë brenda lagjeve të tyre, është e dobët, dhe se ndërgjegjësimi mbi aktivizmin qytetar është shumë i ulët. Sipas pjesëmarrësve në grupet e fokusuara, kultura e komunitetit ka rënë. Si arsye parësore të mungesës së angazhimit të tyre qytetar në nivel personal, pjesëmarrësit përmendin kufizimet kohore, standardet e ulëta të jetesës, sensin e pakët të vullnetarizmit në të mirë të komunitetit dhe mungesën e lidhshimit.**

- “Të gjithë në fshat nuk shikojmë asgjëkund përveç oborrit të vet.” (Shkodër, Mashkull)
- “Nuk jemi aktive, na intereson vetëm zona jonë.” (Korçë, Mashkull);
- “Ne na mungon kjo puna e komunitetit. Në Shqipëri s’ka, të gjithë shikojnë brenda derës së tyre. Këtu nuk paguajnë pastrimin e shkallës.” (Tiranë, Mashkull)
- “Nuk ka lidhje shteti. Ka lidhje me mundësinë tonë që jemi 10 vetë aty, dhe të biem në një ujdë. Do mblidhet shkalla që të zgjedhë kryetarin e shkallës, nuk bëhen. Ca dua unë thotë ai, unë jam në kat të dytë nuk më duhet ashensor. Mua nuk më duhet pastruese thotë ai. Po si nuk të duhet? Këtë po diskutojmë, komuniteti ky është.” (Tiranë, Mashkull)
- “Tani është bërë gjithçka individuale, secili sheh punën e tij, janë shumë të zënë me punë, nuk kanë kohë.” (Tiranë, Femër)
- “Atëherë organizimi i komunitetit siç ka qenë përpara nuk është. Të jemi realë.” (Elbasan, Mashkull)
- “Njerëzit nuk janë të gatshëm të marrin përgjegjësi, nuk janë të gatshëm të përfshihen në punë vullnetare. Janë mësuar gjithmonë me lekë.” (Elbasan, Mashkull)
- “Por kur nuk ke një të ardhur, kur ti je vetë në këto kushte, për shembull e papunë, çfarë mund të ofrosh përveç fjalës? Mund t’i ofrosh për shembull..., nga ana psikologjike, ti ngresh moralin. Këto gjëra po [për aktivitetin në komunitet].” (Elbasan, Femër)
- “Nuk angazhohemi..., për shembull po të marr një qese aty poshtë, përdhe, do qeshi tjetri me neve. Prandaj nuk angazhohemi”. (Elbasan, Femër)
- “Çështja është se nëse nuk shpërblehemi, askush nuk e ndërmerr një nismë të tillë humane. Nëse s’ marr lekë këtu, s’kam pse e bëj.” (Elbasan, Femër)

Kur u pyetën se çfarë do ta nxiste rritjen e angazhimit qytetar, ata përmendën nevojën për hapësira të përshtatshme për t’u mbledhur si dhe për udhëheqje dhe vullnet e qartë për të organizuar qytetarët.

- *Çdo lagje duhet të ketë një vend, dhomë, që të mblidhen, të organizohen, të ketë një lider e të organizohemi që të ndajmë punën.* (Shkodër, Femër)
- *“Nuk ka një njëri që fshati t’i ngrejë problemin.”* (Korçë, Mashkull)
- *“Jemi të ndërgjegjësuar, jemi koshjent për gjithçka por unë e shoh veten shumë të pafuqishëm për të rregulluar diçka në lagjen time për shëmbull.”* (Elbasan, Mashkull)
- *“Për shëmbull nisma që është marrë për plehrat, për pastrimin e ambientit ku jeton. Kjo është diçka që mund të bëhet.”*(Elbasan, Femër)
- *“Shoqërisë nuk i kushton. Të angazhohet qoftë dhe vetëm fizikisht. Nqs ka ndonjë plan unë jam gati që të shkoj. Të bëj një punë.”* (Fieri, Mashkull)
- *“Mendoj që mbajtja e ambientit pastër është gjëja më e rëndësishme po nuk e di se ku duhet të drejtohesh, ku duhet të marrësh pjesë.”* (Fieri, Mashkull)
- *“Na mungon bashkëpunimi. Na duhet ndihmë. [moderatori pyet nga kush] Nga bashkia sepse na mungon iniciativa.”* (Korçë, Femër)

Në përgjithësi, pjesëmarrësit shprehin mosbesim te organizatat e shoqërisë civile dhe shumica e tyre pohojnë se njohin shumë pak, në mos asnjë, grupe të shoqërisë civile aktive në komunitetet e tyre. Ndër ata që janë në dijeni të pranisë së këtyre organizatave, disa dyshojnë në pavarësinë e këtyre grupeve. Shumica e pjesëmarrësve thonë se shoqëria civile nuk është e mirë-organizuar dhe se rezultatet e tyre nuk janë mjaftueshmërisht të dukshme.

- *“Pak [organizata të shoqërisë civile], dhe s’ka aktive.”* (Shkodër, Mashkull)
- *“Nuk i ndjej. Ka organizata po nuk janë të dukshme.”* (Shkodër, Femër)
- *“Këtu në Fier njëherë, asnjë nuk na pyet për problemet që kemi.”* (Fier, Femër)
- *“Jo s’bëjnë punë, s’e dimë nga varen, pastrojnë paratë të huajt nga vende të ndryshme në vende të zhvilluara.”* (Shkodër, Femër)
- *“Besoj se i drejtojnë politikanët (organizatat e shoqërisë civile), nuk janë të pavarura.”* (Tiranë, Mashkull)
- *“Me çfarë kam dëgjuar, këto organizata bëjnë vetëm seminare dhe aktivitete për të mbushur xhepat por asgjë tjetër nuk bëhet. Ata flasin për dhunën ndaj fëmijëve e gjëra të tjera por në fund asgjë nuk funksionon.”* (Korçë, Femër)

Megjithatë, ndryshe nga studimi i grupeve të fokusuar të vitit të kaluar, një numër i vogël pjesëmarrësish mendojnë se aktivizimi në komunitet është përmirësuar, ku një numër shumë i vogël pjesëmarrësish përmendin se ata vetë janë përfshirë në iniciativat e komunitetit dhe ku disa të tjerë diskutojnë për projekte në të cilat do të donin të angazhoheshin. Këto kanë të bëjnë kryesisht me infrastrukturën e lagjeve apo çështjet e pastërtisë. Një numër i vogël pjesëmarrësish –kryesisht në Fier dhe Korçë më shumë se në vendet e tjera– mund të përmendnin shembuj të organizatave të shoqërisë civile të pranishme në komunitetet e tyre. Ndër to, ata përmendën organizata që punojnë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara; çështjet e varfërisë, sidomos ato që kanë të bëjnë me komunitetin Rom, mjedisin dhe dhunën në familje. Pjesëmarrës të tjerë përmendën grupe fetare që janë aktive në vend.

- *“Po ja është një shoqatë islamike që ka ngritur një urë, ku ka qenë një lum i madh , dhe një qendër shëndetësore.”* (Shkodër, Mashkull)

- *“Po nja para dy muajsh kemi shtruar vetë burrë e grua, 2 km rrugë, ishte për faqe të zezë. Të vdiste njeriu rrugës, nuk e çojte dot dhe kemi shtruar 2 km rrugë me zhavor.” (Fier, Femër)*
- *“Po marr si shembull atë që bëra gjatë ditës së pastrimit. Si staf bëmë disa fushata sensibilizuese dhe u fokusuam në këtë çështje specifike, duke filluar me qeset e mbeturinave deri tek pastrimi.” (Fier, Mashkull)*
- *“Punoj bashkia dhe e mbolli me lulishte rreth e rrotull, po aty afër pallatit nuk e bëri. Dhe unë i kam kërkuar pemë atyre të bashkisë dhe e kam mbjellë katin e parë, dhe bashkë me komshien kujdesem.” (Fier, Femër)*
- *“Po duhet të jetë një organizatë. Siç ishte për shembull organizata e të rinjve të Elbasanit që ndihmuan shumë romët. Po të ishte përhapur më shumë nisma unë do të jepja.” (Elbasan, Femër)*
- *“Ndoshta mund të ndihmojmë gratë e sëmura me kancer sepse e kanë jetën në rrezik.” (Korçë, Femër)*
- *“Si për shembull në 22 nëntor [në përgjigje të iniciativës së qeverisë ‘Ta pastrojmë Shqipërinë në një ditë’], kur u organizuam të pastronim dhe dolën të gjithë. Duhet të organizojnë ditën e varfërisë, për shembull, që të dalim të gjithë e të ndihmojmë me ça mundemi.” (Korçë, Femër)*



## Aneks A

Gjetjet e këtij studimi bazohen në dhjetë grupe të fokusuara të zhvilluara si më poshtë:

Numri	Qyteti	Urban/Rural	Punësimi	Gjinia	Mosha	Data
<b>1</b>	<b>Tiranë</b>	Gjysmë Urban	Të papunë / Të punësuar në sektorin publik	Femra	20-40	9 Dhjetor 2013
<b>2</b>	<b>Tiranë</b>	Urban	Të punësuar në sektorin privat / të vetëpunësuar	Meshkuj	36-65	9 Dhjetor 2013
<b>3</b>	<b>Shkodër</b>	Rural	Të papunë / të punësuar në sektorin privat	Meshkuj	22-40	10 Dhjetor 2013
<b>4</b>	<b>Shkodër</b>	Urban	Të papunë / Të punësuar në sektorin publik	Femra	40+	10 Dhjetor 2013
<b>5</b>	<b>Korçë</b>	Rural	Të papunë / të punësuar në sektorin privat	Meshkuj	41-65	11 Dhjetor 2013
<b>6</b>	<b>Korçë</b>	Gjysmë Urban	Të punësuar në sektorin privat /institucionet publike	Femra	22-40	11 Dhjetor 2013
<b>7</b>	<b>Elbasan</b>	Urban	Të papunë / Të punësuar në sektorin publik	Meshkuj	36- 65	12 Dhjetor 2013
<b>8</b>	<b>Elbasan</b>	Gjysmë Urban	Të papunë	Femra	22-40	12 Dhjetor 2013
<b>9</b>	<b>Fier</b>	Urban	Të punësuar në sektorin privat / publik	Meshkuj	22-40	13 Dhjetor 2013
<b>10</b>	<b>Fier</b>	Gjysmë Urban	Të papunë / të punësuar në sektorin privat	Femra	40-65	13 Dhjetor 2013

## **REKRUTIMI I PJESËMARRËSVE**

Pjesëmarrësit në secilin rajon u rekrutuan përmes rrjetit të gjerë të intervistuesve të IDRA-s bazuar në kriteret e paracaktuara të rekrutimit. Një pyetësor rekrutimi u përpilua dhe u përdor gjatë procesit të rekrutimit për të pasur pjesëmarrës me profilin e duhur demografik, përfaqësues të popullsisë së çdo rajoni. Pyetësi i rekrutimit përfshiu pyetje që synonin të identifikonin pjesëmarrës potencialë që plotësonin kriteret e (i) gjinisë; (ii) moshës; (iii) punësimit ; (iv) nivelit të të ardhurave dhe (v) përkatësisë politike. Objektivi madhor i këtij procesi rekrutimi ishte përfshirja në studim e atyre qytetarëve që i përkisnin kategorisë së “qytetarit të zakonshëm”. Dy çështje të rëndësishme duhen shtjelluar në këtë aspekt:

Vëmendje e veçantë iu kushtua përjashtimit të njerëzve të përfshirë në politikë, “militantëve politikë”, nga grupet e diskutimit. Arsyeja kryesore për këtë ka të bëjë me faktin se shpesh ky segment i popullsisë jep pikëpamje që janë shumë të ndikuara nga agjenda politike. Si rrjedhim, informacioni i ofruar nga ky segment i popullsisë rrezikon të jetë ekstrem dhe jo domosdoshmërisht përfaqësues u pikëpamjeve të shumicës së qytetarëve. IDRA, në bashkëpunim të ngushtë me NDI vendosi që të përjashtojë qytetarët që i përkisnin kësaj kategorie nga lista e pjesëmarrësve në grupet e diskutimit.

Ekzistonte gjithashtu një shqetësim tjetër në lidhje me përfshirjen e punonjësve të administratës publike në grupet e diskutimit me supozimin se punonjësit e administratës publike zakonisht janë të orientuar politikisht. Gjithsesi, meqenëse punonjësit e administratës publike përbëjnë një përqindje të lartë të popullsisë së vendit, NDI dhe IDRA morën vendimin që të mos i përjashtonin ata. Sidoqoftë, një vëmendje e veçantë iu kushtua përjashtimit të “militantëve politikë” edhe nga ky grup.

Një numër i madh qytetarësh u përzgjedhën fillimisht në terren nga intervistuesit e IDRA bazuar në një sondazh paraprak me qëllimin e identifikimit të pjesëmarrësve potencialë në grupet e fokusuara, që plotësojnë kriteret e dëshiruara të rekrutimit. Këta qytetarë u filtruan sërisht përmes intervistimit në telefon në mënyrë që të sigurohej se ata plotësonin të gjitha kriteret e paracaktuara. Pjesëmarrësve potencialë iu ofrua një pagesë monetare për kohën e tyre.

## **ZHVILLIMI I INSTRUMENTIT KËRKIMOR PËR GRUPET E FOKUSUARA**

NDI hartoi një guidë diskutimi gjithëpërfshirëse që përmbante çështjet specifike për tu eksploruar gjatë grupeve të diskutimit. Pas rishikimit paraprak dhe redaktimeve nga IDRA, guida u testua gjatë një diskutimi pilot përmes grupeve të fokusuara. Grupi pilot synonte të përcaktonte nëse informacioni i mbledhur nga diskutimi përputhej me objektivat e studimit. Ai gjithashtu testoi nivelin e rëndësisë dhe ndjeshmërisë së çështjeve dhe identifikoi pyetjet që duheshin redaktuar ose fshirë.

Guida e moderimit pati modifikime të vogla në bazë të rezultateve të grupit të fokusuar pilot. Instrumenti përfundimtar përbëhej nga shtatë çështje kryesore diskutimi: (i) Puls i publik dhe drejtimi i vendit, (ii) Prioritetet e qytetarëve, (iii) Integrimi evropian, (iv) Pritshmëritë e qeverisë, (v) Politika në përgjithësi duke përfshirë parlamentin, partitë politike, dhe zgjedhjet, (vi) Gratë në politikë, dhe (vii) Aktivizmi shoqëror.





NDI Washington  
455 Massachusetts Ave., NW 8<sup>th</sup> Floor  
Washington, DC 20001  
Tel: (202) 728-5500 | Fax: (202) 728-5520  
[www.ndi.org](http://www.ndi.org)

NDI Albania  
Rr. Ismail Qemali, 9<sup>th</sup> Floor, Apt. 29  
Tirana, Albania  
Tel/Fax: +355 (04) 2250 392  
[www.ndialbania.org](http://www.ndialbania.org)